



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.185

dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9849
datë 26.12.2007

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë” 5821

Ligj nr.9850
datë 26.12.2007

Për ratifikimin e “Kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë” 5831

LIGJ
Nr.9849, datë 26.12.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS LEVAN-VLORË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5575, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (PROJEKTI I RRUGËS LEVAN-VLORË)
DATË 16 NËNTOR 2007

Marrëveshje e datës 16 nëntor 2007 ndërmjet Republikës së Shqipërisë “Huamarrësi” dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”)

HYRJE

Duke pasur parasysh që Banka ka vendosur të kryejë financime, për projekte të veçanta, për të ndihmuar në kalimin drejt ekonomive të orientuara të hapura të tregut dhe për të përkrahur iniciativën private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të angazhuara dhe duke zbatuar demokracinë shumëpartiake, pluralizmin dhe ekonominë e tregut;

Duke pasur parasysh që Huamarrësi synon të zbatojë projektin, sikurse përshkruhet në planin 1 “Projekti”, i cili u hartua për të asistuar Huamarrësin në ndërtimin e një segmenti rrugor prej afërsisht 24 kilometrash nga Levani në Vlorë, duke formuar pjesë të korridorit veri-jug të Shqipërisë;

Duke pasur parasysh që Huamarrësi ka kërkuar asistencën e Bankës për financimin e një pjese të projektit;

Duke pasur parasysh që Huamarrësi ka qëllim të kontrakttojë një huamarrje nga Banka Europiane e Investimeve “BEI” të shumës prej 23 000 000 eurosh (njëzet e tre milionë eurosh) për të asistuar pjesën B të projektit, sipas kushteve dhe termave të vendosur në një marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe BEI “Kontrata financiare e BEI”;

Duke pasur parasysh që Korporata Italiane për Zhvillim “KIZH” ka rënë dakord të sigurojë një fond granti për të financuar pjesën A dhe C të projektit, këto grante që do të jenë në shumën totale prej 1 200 000 eurosh (një milion e dyqind mijë eurosh) sipas termave të një ose më shumë marrëveshjeve granti ndërmjet KIZH dhe Huamarrësit “Marrëveshje granti të KIZH”;

Duke pasur parasysh që Banka ka rënë dakord, ndër të tjera, paraprakisht, t’i japë hua Huamarrësit sasinë prej 22 000 000 eurosh (njëzet e dy milionë eurosh), sipas termave dhe kushteve të vendosura ose të referuara në këtë Marrëveshje.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termet dhe kushtet standarde; Përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e kushteve dhe të termave standarde të Bankës të datës 1 maj 2006 janë të përfshira dhe të zbatueshme në këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt, sikur të ishin plotësisht të përcaktuara (dispozita të tilla do të quhen këtej e tutje “terma dhe kushte standarde”).

Seksioni 1.02 Përkufizime

Sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë dhe hyrjen dhe planet), nëse nuk citohet ndryshe ose nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptimin përkatës të dhënë atje, termat e përcaktuar në terma dhe kushte standarde kanë kuptimin përkatës të dhënë atje dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm:

<p>“Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit” “BEI”</p>	<p>nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit. ka kuptimin siç përshkruhet në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.</p>
<p>“Kontrata financiare e BEI”</p>	<p>ka kuptimin siç përshkruhet në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.</p>
<p>“Vlerësimi i ndikimit të mjedisit”</p>	<p>nënkupton vlerësimin e ndikimit të mjedisit për projektin e datës shkurt 2007, të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.</p>
<p>“Plani i menaxhimit të mjedisit”</p>	<p>nënkupton planin e menaxhimit mjedisor dhe planin e monitorimit të mjedisit për projektin, të mbështetur në rekomandimet e vlerësimit të ndikimit të mjedisit dhe për të rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, duke siguruar shëndetin dhe sigurinë mjedisore të lidhur me projektin dhe lehtësimin shoqëror, masat menaxhuese dhe monitoruese, standardet, praktikat, politikat dhe procedurat, siç amendohet herë pas here me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës. Plani i menaxhimit mjedisor gjatë fazës së ndërtimit do të zbatohet nga kontraktori i punimeve civile. Plani i menaxhimit mjedisor gjatë fazës operationale është përgjegjësi e Huamarrësit.</p>
<p>“Çështje mjedisore”</p>	<p>nënkupton: a) ndotjen ose mbrojtjen e mjedisit; b) dëmtimin ose mbrojtjen e shëndetit publik; c) shëndetin dhe sigurinë e vendit të punës; ose d) çdo emetim ose substancë të aftë të shkaktojë dëm ndaj organizmave të gjallë ose mjedisit.</p>
<p>“Vit fiskal”</p>	<p>nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.</p>
<p>“Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve”</p>	<p>nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, një departament brenda Ministrisë së Punëve Publike (dhe siç mund të jetë rasti, pasardhësi i tij kohë pas kohë).</p>
<p>“KIZH”</p>	<p>ka kuptimin siç përshkruhet në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.</p>
<p>“Marrëveshje granti KIZH”</p>	<p>ka kuptimin siç përshkruhet në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.</p>
<p>“Të drejtat e tokës”</p>	<p>nënkupton të drejtat e përdorimit të tokës, të nevojshme për zbatimin e pjesës B të projektit.</p>
<p>“Ministria e Punëve Publike”</p>	<p>nënkupton Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë.</p>
<p>“NJZP”</p>	<p>nënkupton njësinë e zbatimit të projektit, referuar në seksionin 3.03.</p>
<p>“Projekti”</p>	<p>ka kuptimin siç përshkruhet në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.</p>
<p>“Plan veprimi i rishlyerjes”</p>	<p>nënkupton planin e veprimit të rishlyerjes për projektin e përfunduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të dorëzuar në Bankë nga Huamarrësi, plani i të cilit do të zbatohet në përputhje me kërkesat e politikës mjedisore të Bankës.</p>

“Plani i ristrukturimit”

nënkupton një plan afatmesëm për ristrukturimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, me qëllime dhe afate kohore për përmirësimin e rregulloreve institucionale për të menaxhuar rrjetin shtetëror rrugor, ku përfshihen:

- a) zhvillimi i Marrëveshjeve financuese të rrugëve;
- b) rishikim të rregulloreve të organizimit dhe menaxhimit për rrugët nacionale dhe propozimet për ndryshime, me vëmendje të veçantë për nevojën në rritje të efektivitetit dhe efikasitetit për rregullime;
- c) reformat institucionale dhe rregullatore të nevojshme për të arritur ndryshimet, dhe
- d) përdorimi në rritje i sektorit privat nëpërmjet konkurrimit të hapur, kjo e justifikuar ekonomikisht dhe fleksibël.

“Mirëmbajtja e rrugëve”

nënkupton të gjitha veprimet e nevojshme për të mirëmbajtur asetet e rrugëve ekzistuese, duke përfshirë kalimet, rampet e rrugëve, bordurat, pjerrësitë, strukturat e kullimit, kanalet nën rrugë, urat, veprat e artit dhe tipare të tjera të nevojshme për të siguruar mirëfunksionimin e rrugës, ku përfshihen:

- a) punimet për:
 - i) riparime të rregullta të kryera në bazë vjetore;
 - ii) riparime periodike të kryera në intervale më tepër se një vit, për të parandaluar përkeqësimin ose për të siguruar performancë të mirë të aseteve të rrugës deri në fund të kohëzgjatjes së saj të parashikuar; dhe
 - iii) rinovimin e aseteve të rrugës për të zgjatur jetëgjatësinë e saj, përtej asaj të planifikuar në fillim;
- b) operacione për planifikim, menaxhim dhe zbatim të punëve të mirëmbajtjes dhe sigurimi i stafit dhe i siguracioneve të tyre shoqërore, plus shpenzimeve dhe lehtësive për të mbështetur këto veprime.

“Çështje sociale”

nënkupton:

- a) standardet e punës dhe kushtet e punësimit, siç rregullohen nga ligji në fuqi;
- b) ndikimin mbi personat e zhvendosur ose nga përvetësimi i tokës;
- c) ndikimin mbi popullsitë indogjene dhe grupet e tjera të pambrojtura;
- d) ndikimin mbi objektet e trashëgimisë kulturore, ku përfshihen qendrat dhe objektet arkeologjike;
- e) konsultimin dhe bërjen publike, duke përfshirë ankimet nga anëtarë të publikut të drejtuara Huamarrësit.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë në një nen, seksion ose plan specifik duhet, përveçse kur caktohet ndryshe në këtë kontratë, të interpretohet si referencë në këtë nen, seksion ose plan specifik të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Termat kryesorë të Huadhënies

Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

Banka është dakord t'i japë hua Huamarrësit, në termat dhe kushtet e shënuara apo të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej 22 000 000 eurosh (njëzet e dy milionë eurosh).

Seksioni 2.02 Terma të tjerë financiarë të huadhënies

a) minimumi i shumës së terheqjes duhet të jetë 300 000 euro (treqind mijë euro);

b) minimumi i shumës së paradhënies duhet të jetë 3 000 000 euro (tre milionë euro);

c) minimumi i shumës së anuluar duhet të jetë 1 000 000 euro (një milionë euro);

d) afatet e pagimit të interesave duhet të jenë 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti.

e) 1. Huamarrësi duhet të shlyejë kapitalin e huasë në 24 këste gjashtëmujore (njëzet e katër) të barabarta (ose sa më të barabarta të jetë e mundur), më 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti, me afatin e parë të shlyerjes së huasë që të jetë 30 prill 2011 dhe afati i fundit i shlyerjes së huasë të jetë 30 tetor 2023.

2. Pavarësisht sa më lart, në rast se: i) Huamarrësi nuk do të tërheqë të gjithë shumën e huasë deri në datën e shlyerjes së parë të huasë, të specifikuar në seksionin 2.02 (e); dhe (ii) Banka zgjat afatin e vlefshmërisë së fundit të specifikuar në seksionin 2.02 (f), pas një date e cila bie pas afatit të shlyerjes së parë të huasë, atëherë shuma e secilës tërheqje të bërë në ose pas afatit të shlyerjes së parë të huasë do të alokohet për shlyerje në shumën të barabarta për disa afate shlyerjeje të huasë, të cilat bien pas datës së kësaj tërheqjeje (me Bankën që përshtat shumën e alokuara si të nevojshme që kështu të arrijë të gjitha shifrat në secilin rast). Banka, herë pas here, do ta njoftojë Huamarrësin për këto alokime;

f) afati i fundit i vlefshmërisë do të jetë 31 mars 2011 ose një datë e mëvonshme, të cilën Banka në zgjedhjen e saj e cakton dhe ia njofton Huamarrësit. Në qoftë se shumën e vlefshme të huasë ose çfarëdo pjesë e saj, është e varur prej një norme fikse interesi dhe Banka e shtyn afatin e fundit të vlefshmërisë, Huamarrësi duhet menjëherë t'i paguajë Bankës shumën e kostove të lëshuara sikurse, kohë pas kohe, duhet të njoftohet nga Banka me shkrim ndaj Huamarrësit;

g) norma e tarifës së angazhimit financiar do të jetë 0.5% në vit;

h) huaja kushtëzohet nga norma e interesit të ndryshueshëm. Pavarësisht për sa më lart, Huamarrësi, si një alternativë e pagimit të interesave në norma interesi të ndryshueshme në të gjithë ose secilën pjesë të huasë së papaguar, mund të zgjedhë të paguajë interesin në një normë fikse interesi në pjesë të tilla të huasë sipas seksionit 3.04 (c) të termave dhe kushteve standarde.

Neni 2.03 Tërheqjet

Shuma e vlefshme mund të tërhiqet kohë pas kohe sipas dispozitave të planit 2 për të financuar:

1) shpenzimet e bëra (ose, nëse banka është dakord, që janë për t'u bërë), për sa i përket kostos së arsyeshme të mallrave, punimeve apo shërbimeve të kërkuara për projektin; dhe 2) komisionin fillestar.

Neni 2.04 Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqjet

Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit për qëllimin e ndërmarrjes së çdo veprimi të kërkuar apo të lejuar për t'u ndërmarrë sipas dispozitave të nenit 2.03.a dhe sipas dispozitave të seksionit 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 3

Ekzekutimi i projektit

Neni 3.01 Marrëveshje të tjera të konfirmuara të projektit

Përveç ndërmarrjeve të përgjithshme të shënuara në nenin IV të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, duhet:

a) Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për

përfundimin e projektit dhe t'i bëjë këto fonde të vlefshme për projektin si kontribute jo të rimbursueshme për të financuar kostot e projektit;

b) Të plotësojë të gjitha detyrimet e tij sipas ose në përputhje me kontratën financiare të BEI dhe Marrëveshjes së grantit të KIZH dhe me të gjitha marrëveshjet e lidhura me projektin.

Neni 3.02 Marrëveshje mbështetëse financiare dhe forcimi institucional

a) Huamarrësi do të rrisë financimin ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë secilit vit fiskal duke filluar nga 1 janari 2008, 1 janari 2009 dhe 1 janari 2010, me shumën jo më pak se 10% në krahasim me financimin e alokuar gjatë vitit fiskal paraardhës;

b) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike, duhet t'i dorëzojë jo më vonë se 31 marsi 2008, Bankës planin e ristrukturimit, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën;

c) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike, siç duhet, në kohë dhe plotësisht të zbatojë planin e ristrukturimit në përputhje me afatet e vendosura këtu dhe, pa kufizuar përgjithësinë e mëparshme, do të prokurojë që Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të transformohet në një agjenci rrugore jo më vonë se 31 dhjetori 2009 ose më parë se kjo datë, siç mund të jetë përcaktuar në planin e ristrukturimit;

d) Huamarrësi do të prokurojë se duke filluar nga viti fiskal 2008, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve do të kontrakttojë të paktën 50% (të matur në terma të vlerës) të gjitha punët periodike të mirëmbajtjes për rrugët, të menaxhuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve te kontraktorët e punimeve civile, të zgjedhura nga procedura tenderuese konkurruese, të pranueshme nga Banka dhe në përputhje me ligjin shqiptar të prokurimeve.

Neni 3.03 Njësia e zbatimit të projektit

a) Njësia e zbatimit të projektit (NJZP) e ngritur nga Huamarrësi do të koordinojë, menaxhojë, monitorojë dhe vlerësojë të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, sipas termave të referencës të pranueshme nga Banka, përfshirë dhe prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për projektin;

b) Huamarrësi, përveç rakordimit tjetër me Bankën, duhet të mbajë NJZP-në gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të projektit dhe të operojë me një njësi zbatimi të projektit me burime të mjaftueshme dhe personel të mirëkualifikuar, sipas termave apo referencave të pranuar nga Banka.

Neni 3.04 Prokurimi

Për qëllimet e nenit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, dispozitat e mëposhtme, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, duhet të rregullojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara nga projekti dhe të financohen jashtë shumave të huasë:

a) punimet duhet të prokurohen me tender të hapur;

b) për qëllimet e nenit 3.04(a), procedurat për tender të hapur përcaktohen në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të BERZH-it;

c) të gjitha kontratat duhet t'i nënshtrohen procedurave të rishikimit, të përcaktuara në aneksin 1 të rregullave të prokurimit të BERZH-it. Të gjitha kontratat duhet t'i nënshtrohen një rishikimi paraprak.

Neni 3.05 Marrëveshje të pajtueshme mjedisore dhe sociale

Pa kufizuar përgjithësinë e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) sikurse specifikohet në planin e menaxhimit mjedisor dhe në planin e veprimeve të rishlyerjes, duhet të zbatojë projektin në përputhje me rregullat mjedisore dhe standardet në fuqi gjerë pas here në juridiksionin në të cilin projekti lokalizohet dhe me standardet mjedisore që ekzistojnë në Bashkimin Europian që prej kësaj date (ose në rast se standarde të tilla nuk ekzistojnë në Bashkimin Europian, sikurse ato janë shënuar në udhëzuesin mjedisor të aplikuar të grupit të Bankës Botërore) dhe politikat ndërkombëtare financiare të korporatave të mbrojtjes në popullsitë indogjene, strehimin jovullnetar dhe pasurinë kulturore, siç referohet në politikën mjedisore të Bankës që prej kësaj date;

b) në përputhje me projektin, Huamarrësi do të mbikëqyrë të gjitha ligjet e zbatueshme dhe standardet në punësim, duke përfshirë dhe ato që lidhen me punësimin e fëmijëve dhe të rinjve, diskriminimin në punë, punën e detyrueshme. Këto ligje dhe standarde të zbatueshme duhet të përfshijnë: i) Konventat bazë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës që kanë të bëjnë me eliminimin e punës së fëmijëve, eliminimin e diskriminimit në vendin e punës, eliminimin e punës së detyruar dhe të detyrueshme dhe ii) ligjin kombëtar;

c) të zbatojë zellshëm dhe t'i përmbahet planit të menaxhimit mjedisor dhe planit të veprimit të rishlyerjes;

d) të bëjë publike planin e menaxhimit mjedisor dhe planin e rishlyerjes në një vend të dukshëm

në ose afër kantierit të projektit;

e) gjatë ekzekutimit të punimeve në lidhje me projektin, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që kantieret e projektit të jenë të menaxhuara në përputhje me praktikën e përparuar ndërkombëtare dhe që:

- i) të ndërmarrë hapa për të menaxhuar trafikun dhe të minimizojë shqetësimet ndaj publikut;
- ii) të ndërmerren masa parandaluese për të garantuar sigurinë e punëtorëve dhe të përdoruesve të rrugës;
- iii) të minimizojë zhurmat dhe interferencat; dhe
- iv) publiku të informohet paraprakisht për punimet e propozuara;
- f) të lejojë përfaqësuesit e Bankës të vizitojnë çdo kantier të projektit ose vend tjetër ku po zbatohet projekti.

Neni 3.06 Konsulentët

a) Me qëllim për të asistuar në zbatimin e projektit, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe me Bankën, Huamarrësi duhet të punësojë ose të detyrojë punësimin, sikurse kërkohet dhe të përdorë konsulentë kualifikimi, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve janë të kënaqshme për Bankën, përfshirë:

1. konsulentë për të asistuar NJZP-në në projektimin dhe mbikëqyrjen e projektit, siç referohet në pjesën C; dhe

2. konsulentë për të asistuar NJZP-në.

b) Huamarrësi duhet t'i sigurojë, pa shpenzime, çdo konsulent të angazhuar për të asistuar në çështje që lidhen me projektin apo operacione të Huamarrësit, të gjitha lehtësitat dhe mbështetjen e nevojshme për zbatimin e funksioneve të tyre, duke përfshirë dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacionin të tjera që mund të jenë të nevojshme për punën e tyre.

Neni 3.07 Frekuenca e raportimit dhe kërkesat për dorëzim

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi dhe deri në pagimin ose anulimin e të gjithë shumës së huasë, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike, duhet t'i paraqesë Bankës raportet vjetore në çështjet e mjedisit dhe çështjet sociale që rezultojnë në lidhje me Huamarrësin ose me projektin brenda 90 ditëve pas mbarimit të vitit për raportim. Raporte të tilla duhet të përfshijnë informacion për çështjet specifike të mëposhtme:

1. informacion në përputhje me kërkesat mjedisore, shëndetësore, të sigurisë dhe sociale të specifikuar në nenin 3.05, duke përfshirë statusin për çdo leje mjedisore të kërkuar për projektin, rezultatet e çdo inspektimi të ekzekutuar nga një autoritet rregullator, çdo shkelje të ligjeve të zbatueshme, të rregullave apo standardeve dhe çdo veprim korrigjues në lidhje me to dhe çdo gjobë të vendosur për çdo shkelje të tillë;

2. informacion për zbatimin e planit të menaxhimit mjedisor dhe të planit të veprimit të rishlyerjes, duke përfshirë çdo ndryshim të propozuar për veprimet, planet apo kostot;

3. një përmbledhje për çdo evidencë materialesh, raportesh apo komunikimesh të tjera në çështjet mjedisore dhe sociale të paraqitura në lidhje me projektin ndaj çdo autoriteti rregullator;

4. informacion për të dhënat shëndetësore dhe të sigurisë së projektit, duke përfshirë normat e aksidenteve dhe çdo iniciativë në lidhje me çështjet e shëndetësisë apo sigurisë që janë zbatuar apo planifikuar;

5. një përmbledhje të ndryshimeve në ligjet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë që mund të kenë efekt material në projekt; dhe

6. kopje të informacionit për çështjet mjedisore dhe sociale të paraqitura periodikisht për publikun.

b) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Huamarrësi, përmes Ministrisë së Punëve Publike, duhet të paraqesë raportet tremujore periodike të projektit të referuara në seksionin 4.04.(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde, brenda 45 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportuar, derisa të plotësohet projekti. Këto raporte duhet të përfshijnë karakteristikat specifike të mëposhtme:

1. informacion i përgjithshëm si më poshtë:

a) progresin fizik të kryer në zbatim të projektit, datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

b) vështirësitë apo vonesat aktuale ose të pritshme në zbatimin e projektit dhe efektet e tyre në planin e zbatimit, si dhe hapat aktualë të ndërmarrë ose të planifikuar për kapërcimin e vështirësive dhe

shmangien e vonesave;

- c) ndryshimet e parashikuara në afatin e përmbushjes së projektit;
- d) ndryshime kyç personeli në stafin e NJZP-së, konsulentët ose kontraktorët e punimeve civile;
- e) çështje që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe
- f) çdo zhvillim apo aktivitet që mund të ndikojë në realizimin ekonomik të çdo pjese të projektit;

2. Një diagramë progresi, e bazuar në planin e zbatimit të projektit, që tregon progresin e secilës pjesë të projektit dhe që përfshin një grafik të shpenzimeve të planifikuara dhe aktuale;

3. Pasqyra financiare që tregojnë detajet e shpenzimeve të ndodhura në secilën pjesë të projektit dhe të tërheqjeve së bashku me pasqyrën që tregojnë:

- a) vlerësimet origjinale të koston;
- b) vlerësimet e rishikuara të koston, nëse ka, me arsyet për ndryshim;
- c) shpenzimet origjinale të vlerësuara dhe shpenzimet aktuale deri më sot;
- d) arsyet për ndryshimet e shpenzimeve aktuale të deritanishme nga shpenzimet origjinale të vlerësuara të deritanishme; dhe
- e) shpenzimet e vlerësuara për tremujorët e mbetur të vitit.

4. Një pasqyrë e shkurtër e statusit të përputhjes me secilën nga marrëveshjet e përmendura në këtë Marrëveshje.

c) Menjëherë pas ngjarjes së ndonjë incidenti apo aksidenti të lidhur me projektin, që mund të ketë një efekt material negativ në mjedis, shëndet apo siguri, Huamarrësi duhet t'i japë Bankës njoftim me faks ose teleks, duke specifikuar natyrën e incidentit apo aksidentit dhe çdo hap që Huamarrësi ndërmerr për ta korrigjuar. Pa kufizuar përgjithësimet e mëparshme, një incident apo aksident mund të ketë një efekt material negativ në mjedis, shëndet apo siguri, nëse një ligj i zbatuar kërkon njoftimin për një incident apo aksident të tillë të autoriteteve qeveritare, një incident apo aksident i tillë përfshin dëme fatale ose shumë serioze që kërkojnë shtrimin në spital, ose një incident apo aksident i tillë është bërë publikisht i njohur nëpërmjet mbulimit nga media, ose ndryshe.

Neni 4

Marrëveshjet financiare

Neni 4.01 Raportet dhe të dhënat financiare

a) Huamarrësi, në lidhje me departamentet ose agjencitë e Huamarrësit, përgjegjëse për zbatimin e projektit ose të ndonjë pjese atje, duhet të mirëmbajë procedurat, shënimet dhe situacionet e duhura për të reflektuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare financiare të pranuar dhe të aplikuara, veprimet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin dhe të monitorojë dhe rakordojë progresin e projektit (duke përfshirë koston dhe avantazhet që burojnë prej tij).

b) Huamarrësi:

1. do të ketë evidencat dhe llogaritë e referuara në nenin 4.01 (a) për secilin vit fiskal të audituar nga auditë të pavarur të pranueshëm nga Banka dhe në përputhje me standardet dhe parimet ndërkombëtare të pranuar të auditimit;

2. do të pajisë Bankën sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas mbarimit të secilit vit fiskal, me raportin e këtij auditimi nga këta auditë në atë shkallë dhe detaje që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

3. do të pajisë Bankën edhe me informacion tjetër në lidhje me këto evidenca dhe llogari dhe auditimi, kur Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Neni 5

Pezullimi, përshpejtimi, anulimi

Seksioni 5.01 Pezullimi

Të mëposhtmet specifikohen për qëllimet e nenit 7.01 (a)(xvii) të termave dhe kushteve standarde:

a) kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatuar në sektorin e rrugëve në territorin e Huamarrësit duhet të jetë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar apo të jetë hequr dorë në një mënyrë tjetër nga rënë dakord me planin e ristrukturimit ose siç është miratuar me shkrim nga Banka; ose

b) e drejta e Huamarrësit të bëjë tërheqje sipas kontratës financiare të KIZH ose të bëjë tërheqje nga fondet e grantit të KIZH duhet të jetë pezulluar, anuluar ose përfunduar në tërësi ose pjesërisht, sipas termave të marrëveshjeve përkatëse, të siguruara sidoqoftë se klauzolat e këtij paragrafi nuk do të zbatohen, nëse Huamarrësi vendos sipas miratimit të Bankës që grantet ose huatë koncesionare të mjaftueshme të sigurojnë fonde të mjaftueshme për projektin, janë të vlefshme për Huamarrësin nga burime të tjera, me terma dhe kushte në përputhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5.02 Përshpejtimi i maturimit

Të mëposhtmet specifikohen për qëllimet e seksionit 7.06 (f) të termave dhe kushteve standarde:

a) çdo ngjarje të specifikuar në seksionin 5.01 e cila do të vazhdojë për tridhjetë ditë pas njoftimit të dhënë nga Banka për Huamarrësin të vendosjes nga Banka që kjo ngjarje ka ndodhur, duke citur atje dëshirën e Bankës për të ndërmarrë veprim në përputhje me nenin 7.06 të kushteve dhe termave standarde.

Neni 6 Efektiviteti

Seksioni 6.01 Kushtet precedente ndaj efektivitetit

Të mëposhtmet specifikohen për qëllimet e nenit 9.02 (c) të termave dhe kushteve standarde, si kushte plotësuese për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje:

a) Banka duhet të pajiset me situacionin, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, se kontrata financiare e BEI-it është ekzekutuar dhe dorëzuar dhe është në fuqi dhe efekt dhe të gjitha kushtet precedente të efektivitetit të saj ose të së drejtës së Huamarrësit të bëjë tërheqje, përveç efektivitetit të kësaj Marrëveshjeje, janë përmbushur:

b) Banka duhet të pajiset me evidencë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, të ratifikimit parlamentar të kësaj Marrëveshjeje;

c) Banka duhet të pajiset dhe ka miratuar planin e menaxhimit mjedisor;

d) Banka duhet të pajiset me evidencë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, se të gjitha të drejtat e tokës së nevojshme për zbatimin e projektit janë përfituar nga Huamarrësi dhe janë bërë të vlefshme për kontraktorin e punimeve civile (ose që Huamarrësi ka të drejtën për t'i përfituar këto të drejta të tokës në përputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm dhe që shumica të mjaftueshme janë vënë nën menjancë nga Huamarrësi për të përfituar këto të drejta të pronës në kohën e duhur) dhe konfirmimi se plani i veprimit të rishlyerjes është zbatuar në përputhje me politikën e Bankës;

e) Banka duhet të pajiset me evidencë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, se NJZP-ja është ngritur me burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar në nivel të kënaqshëm, sipas termave të referencës të pranuar për Bankën;

f) Banka duhet të pajiset me evidencë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, se marrëveshja e grantit të KIZH-it për pjesën C të projektit është ekzekutuar dhe shpërndarë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe se e drejta e Huamarrësit për të tërhequr sipas kësaj Marrëveshjeje, është bërë efektive.

Seksioni 6.02 Mendimi ligjor

Për qëllimet e nenit 9.03 (a) të termave dhe kushteve standarde, mendimi ose mendimet e këshilltarit duhet të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë dhe duhet të jenë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën.

Seksioni 6.03 Përfundimi për moskryerje për t'u bërë efektive

Data 120 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje specifikohet për qëllimet e seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 7 Të ndryshme

Seksioni 7.01 Shënime

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve dhe termave standarde:

Për Huamarrësin:

Për Bankën:

Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit", 1
Tiranë
Shqipëri

Për dijëni: Ministrit të Financave
Faks: (355) (4) 228494

Në dëshmi sa më sipër, Palët e kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar me shkrim, nënshkruajnë këtë Marrëveshje në katër kopje dhe të dorëzuar në Tiranë, Shqipëri, sipas ditës dhe vitit të shkruar më sipër.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Për dijëni: Njësia e Administrimit Operacional
Fax: + +44-20-7338-6100

Republika e Shqipërisë
Nga: _____
Emri: Ridvan Bode
Titulli: Ministër i Financave

Banka Europiane
Për Rindërtim dhe Zhvillim
Nga: _____
Emri: Sue Barrett
Titulli: Zëvendës drejtor

PLANI I PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë Huamarrësin në ndërtimin e rrugës me katër korsi afërsisht 24.2 kilometra nga Levani në Vlorë, e cila është pjesë e korridorit veri-jug të Shqipërisë dhe e Korridorit Transeuropian VIII.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, sipas ndryshimeve, sikurse Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A: Përgatitja e projekteve inxhinierike dhe dokumenteve të tenderit.

Pjesa A e projektit është financuar nga KIZH.

Pjesa B: Ndërtimi i rrugës me katër korsi afërsisht 24.2 kilometra nga Levani në qytetin e Vlorës.

Punimet për pjesën B të projektit, duke përfshirë taksat, do të bashkëfinancohen nga BEI. Huamarrësi do të financojë për shpronësimin e tokës dhe të gjitha taksat në lidhje me pjesën B të projektit (përfshirë në lidhje me kontratat e punimeve civile).

Pjesa C: Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit për projektin të referuar në pjesën B.

Do të caktohet një konsulent supervizioni, i cili do të monitorojë zbatimin e punimeve të pjesës B të projektit. Këto shërbime do të financohen nga KIZH.

3. Projekti pritet të përfundojë, më dhjetor 2010.

PLANI 2 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëlidhur këtij plani shënon kategoritë, shumën e huasë të alokuar në çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar për çdo kategori.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit të mësipërm, asnjë tërheqje nuk duhet të bëhet në lidhje me shpenzimet e bëra para datës së Marrëveshjes së huasë; dhe përveç kur tërheqjet në shumën totale nuk i tejkalojnë 2 500 000 euro (dy milionë e pesëqind mijë euro) mund të bëhen (me efekt prapaveprues) në lidhje me kategorinë 1 në rast të shpenzimeve të bëra para datës së Marrëveshjes së huasë, por pas datës 31 mars 2007.

Bashkëlidhja e planit 2

Kategoria	Shuma e huasë e alokuar në monedhën e huasë	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1. Punimet për pjesën B të projektit	21 780 000 euro	50% të vlerës së kontratës, duke përfshirë taksat

2. Komisioni fillestar	220 000 euro	100%
TOTALI	22 000 000 euro	

LIGJ
Nr.9850, datë 26.12.2007

PËR RATIFIKIMIN E “KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS LEVAN-VLORË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Kontrata financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5576, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

FI nr. </> (AL)
SERAPIS nr. 2006 - 0322

RRUGA LEVAN - VLORË KONTRATË FINANÇIMI NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR INVESTIM
TIRANË 16 NËNTOR 2007

Kjo kontratë lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave, z. Ridvan Bode (këtu e tutje, gjithashtu i quajtur “Huamarrësi”), për Palën e parë dhe, Bankës Europiane për Investim me seli në “Konrad Adenauer” blv. nr.100, L-2950, Luksemburg, përfaqësuar nga Zëvendës shefi i Departamentit, z.Fulceri Bruni Roccia dhe nga oficeri i huasë, z.Peter Zajc _____ (këtu e tutje e quajtur “Banka”) për Palën e dytë.

Duke pasur parasysh që:

1. Huamarrësi ka deklaruar se ai dëshiron të ndërmarrë një projekt (këtu e tutje i quajtur “Projekti”) nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (DPRR) në Ministrinë e tij të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (tani e tutje i quajtur “Përkrahësi”), lidhur me ndërtimin e një autostrade të shpejtë me 2 X 2 korsi ndërmjet Levanit dhe qytetit të Vlorës me gjatësi totale prej 24 km me qëllim përmirësimin e kapacitetit, sigurisë së trafikut dhe kohës së udhëtimit në këtë aks rrugor të

rëndësishëm veri-jug dhe përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, vlerësimeve të impaktit mjedisor dhe kontrolleve të sigurisë rrugore për projektet e ardhshme, të përfshira në programin e investimit rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe të konsideruara për financim nga Banka, ashtu siç përshkruhet në mënyrë të posaçme në përshkrimin teknik (tani e tutje i quajtur “Përshkrimi teknik” ekspozuar në pasqyrën A.1 të këtij dokumenti.

2. Kostoja totale e projektit, sipas vlerësimit të Bankës, konsiston në 63 100 000 euro (gjashtëdhjetë e tre milionë e një qind mijë euro) për t’u financuar si më poshtë:

Burimi	Shuma (milionë euro)
Kredi nga Banka	26.0
Hua nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim	22.0
Qeveria e Italisë	0.8
Fondet e veta të Huamarrësit	14.3
Totali	63.1

3. Me qëllim plotësimin e planit financiar të ekspozuar në përshkrimin (2), Huamarrësi i ka kërkuar Bankës një kredi të parë deri në 23 000 000 euro (njëzet e tre milionë euro) për financimin e projektit, nga të cilat 1 000 000 euro (një milion euro) është menduar të përdoret për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, vlerësimeve të impaktit mjedisor dhe kontrolleve të sigurisë rrugore për projektet e ardhshme të përfshira në programin e investimit rrugor të Republikës së Shqipërisë.

4. Me vendimin nr.2006/1016/EC, Këshilli i Bashkimit Europian ka vendosur t’i japë Bankës një garanci, përkundrejt humbjeve të shkaktuara nga ajo sipas huave dhe garancive të huasë të dhëna nga 2007 deri në 2013, në përputhje me rregullat dhe procedurat e veta për projektet e kryera në disa vende jashtë Bashkimit Europian, të renditura në vendimin e mësipërm, midis të cilave Republika e Shqipërisë, me kusht që këto vende të kenë përfunduar me Bankën një marrëveshje kuadër, që rregullon aktivitetet e kësaj të fundit.

5. Marrëveshja kuadër, e cila drejton aktivitetet e Bankës në territorin e Shqipërisë, e nënshkruar më 5 shkurt 1998 nga ana e Huamarrësit dhe Bankës (këtu e tutje e quajtur “Marrëveshja kuadër”), aplikohet ndaj kësaj kontrate.

6. Statuti i Bankës parashikon që Banka të sigurojë që fondet e saj të përdoren në mënyrë sa më racionale që të jetë e mundur në interes të Komunitetit Europian dhe për pasojë afatet dhe kushtet e veprimeve huadhënëse të saj, të jenë në përputhje me politikat përkatëse të Komunitetit Europian.

7. Në përgjigje të kërkesës së Huamarrësit, e kënaqur që financimi i projektit realizohet brenda shtrirjes së funksioneve të tij dhe duke u bazuar, ndër të tjera, në deklaratimet dhe faktet e përmendura në këto përshkrime, Banka dëshiron të vendosë në dispozicion të Huamarrësit një kredi të parë prej 23 000 000 eurosh (njëzet e tre milionë eurosh) ose ekuivalentin e saj, sipas kësaj kontrate financimi (këtu e tutje e quajtur “Kontrata”).

8. Referimet në këtë dokument kundrejt “Neneve”, “Përshkrimeve” dhe “Pasqyrave” janë referime respektive të neneve, përshkrimeve dhe pasqyrave të kësaj kontrate, rrjedhimisht, tashmë është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kredia dhe disbursimi

1.01 Shuma dhe akordimi i kredisë

Me anë të kësaj kontrate, Banka vendos në dispozicion të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon, një kredi (tani e tutje e quajtur “Kredia”) në një shumë deri në 23 000 000 euro (njëzet e tre milionë euro) ose ekuivalentin e saj për të financuar projektin.

1.02 Procedura e disbursimit

1.02(1) Transhet

Banka disburson kredinë deri në 11 (njëmbëdhjetë) transhe. Shuma e çdo transhi, nëse nuk përbën shumën e pa tërhequr për t’u paguar, konsiston në një minimum prej 2 000 000 eurosh (dy milionë eurosh) ose ekuivalentin e saj, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga ana e Bankës. Një transh

i kërkuar nga ana e Huamarrësit sipas nenit 1.02 (2) referohet këtu e tutje si “Transh”.

1.02(2) Kërkesa për disbursim

Herë pas here deri më 31 dhjetor 2010, Huamarrësi mund t'i paraqesë Bankës një kërkesë me shkrim (një “Kërkesë për disbursim”), kryesisht në formën e paraqitur në tabelën C për disbursimin e një kësti. Kërkesa për disbursim duhet të jetë në Bankë të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike para datës së preferuar të disbursimit. Me përjashtim të rasteve kur treguesit tashmë janë plotësuar, kërkesa për disbursim shoqërohet me dëshminë/treguesin e autoritetit nënshkrues së bashku me mostrat e firmës/firmave autentike të tyre. Kërkesa për disbursim specifikon:

- i) shumën dhe monedhën e këstit;
- ii) datën e preferuar të disbursimit, e cila konsiston në një ditë përkatëse pune (siç është përcaktuar në nenin 5.01), duke pasur parasysh që Banka mund të disbursojë këstin deri në katër (4) muaj kalendarikë nga data e kërkesës për disbursim;
- iii) nëse kësti mbart një normë fikse interesi (d.m.th. konsiston në një “Këst me normë fikse”) ose në një normë interesi të ndryshueshme në një shtrirje kohore të caktuar (d.m.th. një “Këst me normë të ndryshueshme për shtrirje të përcaktuar”, ose “Këst NNSHP”, në të dy rastet sipas dispozitave përkatëse të nenit 3.01;
- iv) periudhën e preferuar të pagesës së interesit të këstit të përzgjedhur në përputhje me nenin 3.01;
- v) periudhën e preferuar të pagesës së principalit të përzgjedhur në përputhje me nenin 4.01;
- vi) datat e preferuara të pagesës së përzgjedhur në përputhje me nenin 5.01.

Huamarrësi, mund gjithashtu sipas gjykimit të tij të specifikojë në kërkesën për disbursim elementet respektive të mëposhtme, nëse ekzistojnë, ashtu siç është treguar më parë nga ana e Bankës pa u angazhuar që të aplikohen për këstin gjatë kohëzgjatjes së tij d.m.th. me fjalë të tjera:

- i) në rastin e një kësti me normë fikse, normën e interesit; dhe
- ii) në rastin e një kësti me normë të ndryshueshme dhe shtrirje të përcaktuar, shtrirjen (siç përcaktohet në nenin 3.01).

Për qëllim të kësaj kontrate në përgjithësi “Norma ndërbankare përkatëse” nënkupton:

- EURIBOR në rastin e një kësti të emërtuar në euro;
- LIBOR në rastin e një kësti të emërtuar në USD ose GBP (Paund britanik); dhe
- normën e tregut dhe përcaktimin e saj të përzgjedhur prej Bankës, e cila i komunikohet Huamarrësit më vete në rastin e një kësti të emërtuar në çdo monedhë tjetër.

Në varësi të paragrafit të parafundit të nenit 1.02(3), çdo kërkesë për disbursim është e parevokueshme.

1.02(3) Njoftimi i disbursimit

Ndërmjet dhjetë (10) dhe pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e disbursimit të një transhi, Banka, nëse kërkesa për disbursim konsiston në përputhje me nenin 1.02(2), i paraqet Huamarrësit një njoftim (këtu e tutje “Njoftimi i disbursimit”), i cili specifikon:

- i) shumën dhe monedhën e disbursimit;
- ii) datën në të cilën kësti planifikohet të disbursohet (këtu e tutje e quajtur “Data e disbursimit të planifikuar”), disbursimi i varur në çdo rast nga kushtet e nenit 1.04;
- iii) bazën e normës së interesit;
- iv) për një këst me normë fikse, normën fikse të interesit dhe për një këst me normë të ndryshueshme dhe shtrirje të përcaktuar, shtrirjen;
- v) afatet e pagesës së principalit dhe periudhës së pagesës së interesit; dhe
- vi) datat e aplikimit të pagesës.

Në rast se një ose më shumë nga elementet e specifikuara në njoftimin e disbursimit nuk pajtohet me elementin korrespondues, nëse ekziston, në kërkesën e disbursimit, Huamarrësi, brenda tri (3) ditëve pune të Luksemburgut pas marrjes së njoftimit për disbursim, mund të anulojë kërkesën për disbursim me anë të një njoftimi drejtuar Bankës dhe me marrjen e njoftimit, kërkesa për disbursim dhe njoftimi i disbursimit nuk kanë më efekt.

Për qëllim të kësaj kontrate, në përgjithësi, “Ditë pune e Luksemburgut” nënkupton një ditë në të cilën bankat tregtare janë të hapura për të kryer shërbime në Luksemburg.

1.03 Monedha dhe përlllogaritja e disbursimit

1.03(1) Monedha e disbursimit

Në varësi të disponueshmërisë, Banka disburson çdo transh në monedhën për të cilën

Huamarrësi ka shprehur preferencën e tij. Çdo monedhë e disbursuar konsiston në euro, USD ose gbp (Paund britanik), ose çdo monedhë tjetër, e cila tregtohet gjerësisht në tregjet e huaja kryesore të shkëmbimeve valutore dhe e cila, në rastin e një transhi me normë të ndryshueshme dhe shtrirje të përcaktuar, konsiston në një monedhë, e cila disponohet nga Banka me norma interesi variabël.

Për përllogaritjen e shumave të disponueshme për t'u disbursuar në monedha ndryshe nga euro dhe për caktimin e ekuivalentit të tyre në euro, Banka aplikon normën e publikuar prej Bankës Qendrore Europiane në Frankfurt në atë datë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve para disbursimit sipas vendimit të saj.

1.03(2) Përllogaritja e disbursimit

Shuma e çdo transhi depozitohet nga ana e Bankës në një numër llogarie që mbart një kod IBAN dhe Swift BIC-it për të shoqëruar kërkesën e parë për disbursim, të cilat i komunikohen me shkrim Bankës nga ana e një zyrtari/nëpunësi të autorizuar sipas rregullave të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

1.04 Kushtet e disbursimit

1.04(1) Transhi i parë

Disbursimi i transhit të parë, sipas kësaj kontrate, është në varësi të plotësimit të kushteve të mëposhtme, sipas gjykimit të Bankës, në mënyrë që kryesisht në datën, ose para ardhjes së datës që përkon me shtatë (7) ditë zyrtare pune të Luksemburgut që paraprin datën e disbursimit të planifikuar:

i) Banka të ketë marrë një opinion ligjor prej Ministrit të Drejtësisë të Huamarrësit ku:

a) të konfirmohet se zbatimi i kësaj kontrate është autorizuar siç duhet me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, të konfirmohet se nënshkruesit e kësaj kontrate kanë fuqi të mjaftueshme për të nënshkruar në emër të Huamarrësit, të konfirmohet se kjo kontratë përkon me shtrirjen e Marrëveshjes kuadër, të konfirmohet se Parlamenti i Huamarrësit ka ratifikuar siç duhet këtë kontratë, të konfirmohet se dispozitat e kësaj kontrate kanë fuqi dhe efekt të plotë dhe se ajo është e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në Shqipëri sipas kushteve të saj;

b) të sigurohen të dhëna mbi autoritetin e personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar kërkesa për disbursim dhe mostrat e firmave autentike të personit apo personave përkatës; dhe

c) të konfirmohet se të gjitha miratimet e nevojshme të kontrollit të këmbimit janë siguruar me qëllim lejimin e Huamarrësit për të përfutur shumat e disbursuara, sipas kësaj kontrate për të shlyer huanë dhe interesin dhe të gjitha shumat e tjera përkatëse sipas kësaj kontrate dhe se miratime të tilla shtrihen deri në hapjen dhe ruajtjen e llogarive në të cilat Huamarrësi do të drejtojë Bankën për të disbursuar kredinë;

ii) Livruesi duhet të ketë siguruar se një audit/kontroll i sigurisë së lëvizjes së projektit së detajuar është përfunduar. Aq sa të jetë e realizueshme, rekomandimet e këtij auditimi duhet të jenë përfshira në qëllimin/planin e projektit sipas gjykimit të Bankës; dhe

iii) Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i Republikës së Shqipërisë të ketë konfirmuar me shkrim se ekipi i zbatimit të projektit (EIP), i ndodhur në GRD, mbetet autoriteti kompetent për zbatimin e projektit.

1.04(2) Të gjitha transhet

Për më tepër, disbursimi i çdo kësti sipas nenit 1.02(2), përfshirë të parin, i nënshtohet faktit që Banka të ketë marrë nga Huamarrësi në datën ose datën që përkon me ditën e shtatë (7) zyrtare të punës së Luksemburgut, që paraprin datën përkatëse të disbursimit të planifikuar, dokumentacionin ose të dhënat e mëposhtme në formë dhe përmbajtje të pëlqyeshme për të:

i) të dhëna se Livruesi ka pasur ose është i angazhuar në bazë kontraktuale deri në datën e kërkesës për disbursim të pësojë shpenzime kualifikuese brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas datës përkatëse të disbursimit të planifikuar në një shumë totale të paktën të barabartë me 80% të shumës së transhit që do të disbursohet dhe të gjitha transheve paraprirëse, nëse kanë ekzistuar, përjashtojë transhin e fundit ku shumat duhet të jetë e barabartë me totalin e shumave të të gjitha transheve të disbursuara më parë dhe të shumës së transhit që do të disbursohet, "Shpenzime kualifikuese" nënkupton shpenzime (përfshirë pagesat paradhënie kundrejt kontraktuesit, koston e projektimit dhe drejtimit, nëse është e aplikueshme dhe shumën neto të taksave dhe detyrimeve që paguhen nga ana e organizatorit të shkaktuara prej Livruesit për sa i përket punimeve, mallrave dhe shërbimeve për artikujt e specifikuar si të pranueshëm për financim, në bazë të kësaj kontrate në përshkrimin teknik;

ii) të dhëna që fondet e përmendura në përshkrimin 2 për zbatimin e projektit janë në dispozicion

të organizatorit; dhe

iii) një certifikatë nga ana e Huamarrësit në formën e pasqyrës D.

Për të përlloritur ekuivalentin në euro të shumave të shpenzuara, Banka aplikon kursin e këmbimit të përmëndur në nenin 1.03.

1.04(3) Disbursime të mëtejshme

Disbursimi i çdo transhi sipas nenit 1.02(2), që pason transhin e parë, i nënshtrohet faktit që Banka të ketë marrë prej Huamarrësit në datën ose që përkon me ditën e shtatë (7) zyrtare të punës të Luksemburgut që paraprin datën përkatëse të disbursimit të planifikuar, dokumentacionin ose të dhënat e mëposhtme në formë dhe përmbajtje të pëlqyeshme:

i) të dhëna të cilat i tregojnë Bankës se kushtet e mëposhtme janë plotësuar para fillimit të çdo punimi ndërtimor të përhershëm:

a) të gjitha të drejtat e tokës së nevojshme për zbatimin e projektit, të jenë siguruar nga ana e Huamarrësit dhe t'i jenë vënë në dispozicion kontraktuesit të punimeve civile (ose që Huamarrësi të ketë të drejtën për të siguruar të drejtat e tokës në fjalë sipas ligjit shqiptar në fuqi dhe se shuma të mjaftueshme janë rezervuar nga ana e Huamarrësit për të siguruar të drejtat e tokës në fjalë në kohën e duhur);

b) kujdesi i duhur ndaj mjedisit të jetë përfunduar me sukses, vërtetuar nga marrja e të gjitha lejeve përkatëse;

c) autoriteti kompetent mjedisor të ketë konfirmuar me shkrim se projekti pajtohet me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së natyrës për zonat e prekshme mjedisore;

d) të jetë emëruar një inxhinier mbikëqyrës;

ii) një përmbledhje e masave të përcaktuara për të parandaluar kompleksat afër lagunës së Nartës dhe masave për të kufizuar hyrjen në autostradën e shpejtë në përgjithësi; dhe

iii) mirëmbajtje dhe strategji operuese të duhura të pranueshme nga ana e Bankës mbi projektin, përfshirë akordimin e fondeve të nevojshme për të siguruar mirëmbajtjen e strukturës rrugore që i korrespondon standardeve ndërkombëtare.

1.04(4) Dispozita të përgjithshme mbi kushtet e disbursimit

Në rastin kur kërkesa për disbursim paraqitet pa u plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 1.04, një kërkesë e tillë për disbursim gjykohet të jetë marrë prej Bankës datën në të cilën ajo është e bindur se kushtet në fjalë janë plotësuar.

Pa cenuar dispozitën e paragrafit paraprirës, nëse një pjesë e dokumentacionit të marrë sipas nenit 1.04, nuk pëlqehet nga ana e Bankës, Banka mund ta disbursojë pa cenuar shumën minimale të përcaktuar në nenin 1.02(1), një shumë të barabartë me shumën që bëhet fjalë në kërkesën përkatëse të disbursimit pa shumën që i korrespondon shpenzimeve kualifikuese të padokumentuara dhe të parashikuara.

1.05 Shtyrja e disbursimit

1.05 (1) Arsyet për shtyrje

Banka, me marrjen e një kërkesë me shkrim prej Huamarrësit, shtyn disbursimin e çdo kësti pjesërisht ose tërësisht deri në një datë të specifikuar nga ana e Huamarrësit, e cila i përket një date jo më të vonshme se gjashtë (6) muaj nga data e planifikuar për disbursim. Në një rast të tillë, Huamarrësi paguan dëmshpërblim për shtyrje afati siç përcaktohet sipas nenit 1.05 (2) më poshtë. Çdo kërkesë për shtyrje ka efekt për sa i përket një transhi, vetëm nëse ajo paraqitet të paktën shtatë (7) ditë zyrtare të Luksemburgut para datës së disbursimit të planifikuar.

Nëse ndonjë nga kushtet e përmendura në nenin 1.04 nuk plotësohet brenda një date të caktuar dhe brenda datës së disbursimit të planifikuar, disbursimi shtyhet për një datë të rënë dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, e cila përkon jo më pak se shtatë (7) ditë zyrtare pune të Luksemburgut, pas plotësimit të të gjitha kushteve të disbursimit në mënyrë të pëlqyeshme për Bankën.

1.05(2) Dëmshpërblimi i shtyrjes

Nëse disbursimi i një transhi të njoftuar (siç përcaktohet më poshtë në këtë nen) shtyhet, qoftë me kërkesë të Huamarrësit siç përcaktohet në nenin 1.05(1) ose për shkak të mosplotësimit të kushteve të disbursimit, Huamarrësi, me kërkesë nga ana e Bankës, paguan një dëmshpërblim mbi shumën për të cilën disbursimi është shtyrë. Dëmshpërblimi në fjalë rrjedh nga data e planifikuar për disbursim deri në datën aktuale të disbursimit ose, sipas rastit, deri në datën e anulimit të transhit me një normë të barabartë me R1-R2, ku:

“R1” nënkupton normën e interesit, e cila do të aplikohet herë pas here sipas nenit 3.01 dhe njoftimit përkatës të disbursimit, nëse transhi do të ishte disbursuar në datën e planifikuar të disbursimit dhe

“R2” nënkupton normën përkatëse ndërbankare pa 0.125% (12.5 pikë bazë), me kusht që për qëllim të përcaktimit të normës përkatëse ndërbankare lidhur me këtë nen 1.05, periudhat përkatëse të parashikuara në pasqyrën B të jenë periudha pasuese një (1) mujore, të cilat fillojnë në datën e planifikuar të disbursimit.

Për më tepër, dëshmërbliimi:

- a) nëse shtyrja e kalon kohëzgjatjen një (1) muaj, shtohet në fund të muajit;
- b) përllogaritet duke përdorur marrëveshjen e numërimit ditor të aplikueshëm për R1;
- c) kur R2 e tejkalon R1, vendoset në zero; dhe
- d) paguhet sipas nenit 1.07.

Në këtë kontratë “Transh i njoftuar” nënkupton një transh për të cilin Banka ka lëshuar një njoftim disbursimi.

1.05(3) Anulimi i disbursimit të shtyrë për gjashtë muaj

Banka, duke u njoftuar nga Huamarrësi, mund ta anulojë një disbursim, i cili është shtyrë sipas nenit 1.05(1) për më shumë se gjashtë (6) muaj në total. Shuma e anuluar mbetet në dispozicion për disbursim sipas nenit 1.02.

1.06 Anulimi dhe pezullimi

1.06(1) E drejta e Huamarrësit për të anuluar

Huamarrësi, me anë të një njoftimi drejtuar Bankës, mund në çdo kohë ta anulojë pjesërisht ose plotësisht dhe me efekt të menjëhershëm pjesën e padisbursuar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk ka efekt mbi një transh të njoftuar tashmë data e planifikuar e disbursimit e të cilit përkon brenda shtatë (7) ditëve zyrtare të Luksemburgut pas datës së njoftimit.

1.06(2) E drejta e Bankës për të pezulluar dhe anuluar

Banka, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, mund të anulojë dhe/ose pezullojë pjesërisht ose plotësisht pjesën e padisbursuar të kredisë në çdo moment dhe me efekt të menjëhershëm:

- i) në rastin e një ngjarjeje të përmendur në nenin 10.01; ose
- ii) në rrethana të veçanta, të cilat ndikojnë negativisht në aksesin e Bankës në tregun financiar, përjashtojt rastet e transhit të njoftuar; ose
- iii) nëse, sipas gjykimit të saj, Banka nuk është e kënaqur me zbatimin e garancive dhe premtimeve të siguruar nga ana e Huamarrësit në nenet 6 dhe 8.04.

Për më tepër, përderisa Banka mund të anulojë kredinë sipas nenit 4.03(1), ajo mund gjithashtu ta pezullojë atë. Çdo pezullim vazhdon derisa Banka i jep fund pezullimit ose anulon shumën e pezulluar.

1.06(3) Dëshmërbliimi për pezullimin dhe anulimin e një transhi

1.06(3)(i) Pezullimi

Nëse Banka pezullon një transh të njoftuar, si rrjedhojë e një ngjarjeje të përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi dëshmërbli Bankën sipas nenit 1.05(2).

1.06(3) Anulimi

Nëse një transh i njoftuar me normë fikse anulohet nga ana e Huamarrësit sipas nenit 1.06(1) më sipër, Huamarrësi dëshmërbli Bankën sipas nenit 4.02(2)(i). Nëse një pjesë e kredisë, përveç transhit të njoftuar, me normë fikse anulohet nga ana e Huamarrësit sipas nenit 1.06(1) më sipër, nuk paguhet dëshmërbliimi.

Nëse Banka anulon disbursimin e një transhi me normë fikse sipas nenit 1.05(3), Huamarrësi dëshmërbli Bankën sipas nenit 4.02(2)(i). Nëse Banka anulon një transh të njoftuar, si rrjedhojë e një ngjarjeje të përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi dëshmërbli Bankën sipas nenit 10.03. Përveç këtyre rasteve, asnjë lloj dëshmërbliimi nuk paguhet për aulime nga ana e Bankës.

Dëshmërbliimi përllogaritet në mënyrë që shumën e anuluar të gjykohet sikur të ishte livruar dhe paguar në datën e planifikuar të disbursimit ose sikur disbursimi i transhit të jetë shtyrë, ose pezulluar aktualisht në datën e njoftimit për anulim.

1.06(4) Anulimi mbas mbarimit të afatit të kredisë

Në çdo kohë mbas afatit për të paraqitur një kërkesë për disbursim nga ana e Huamarrësit sipas nenit 1.02(2), Banka me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit dhe pa përgjegjësi pasuese për asnjë nga palët, mund të anulojë çdo pjesë të kredisë, përveçse transhit të njoftuar.

1.07 Shumat për t’u paguar sipas nenit 1

Shumat për t'u paguar sipas nenit 1.05 dhe 1.06 paguhen në monedhën e transhit në fjalë. Ato paguhen brenda shtatë (7) ditëve kalendarike pas marrjes së kërkesës së Bankës nga ana e Huamarrësit ose brenda çdo periudhe tjetër më të gjatë të specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës.

Neni 2 **Huaja**

2.01 Vlera e huasë

Huaja e realizuar në bazë të kreditimit (këtu e tutje referuar si "Huaja") përbën totalin e vlerave të disbursuara nga ana e Bankës, siç është njoftuar prej saj në rastin e disbursimit të çdo transhi.

2.02 Monedha e shlyerjes

Çdo shlyerje e një transhi sipas nenit 4 ose sipas rastit, nenit 10, konsiston në monedhën e transhit.

2.03 Monedha e interesit dhe detyrime të tjera

Interesi dhe çdo detyrim tjetër i aplikueshëm që paguhet nga ana e Huamarrësit sipas neneve 3, 4 dhe, kur është e aplikueshme, nenit 10, përlllogaritit dhe shlyhet për sa i përket çdo transhi në monedhën e transhit.

Çdo shlyerje tjetër realizohet në monedhën e specifikuar nga ana e Bankës, duke pasur parasysh monedhën e shpenzimeve për t'u disbursuar me anë të shlyerjes në fjalë.

2.04 Konfirmimi i Bankës

Pas çdo disbursimi të një transhi, Banka i paraqet Huamarrësit një formulim përmbledhës ku tregohet data e disbursimit, monedha dhe sasia, afatet e shlyerjes dhe norma e interesit të transhit në fjalë. Një konfirmim i tillë përfshin një tabelë amortizimi/likuidimi.

Neni 3 **Interesi**

3.01 Norma e interesit

3.01(1) Transhe me normë fikse

Huamarrësi paguan interesin e shumës së papaguar për t'u paguar të çdo transhi me normë fikse dy herë në vit ose çdo vit në datat përkatëse të shlyerjes siç specifikohet në njoftimin përkatës të disbursimit, duke filluar nga data e parë e shlyerjes mbas datës së disbursimit të transhit.

Interesi përlllogaritit mbi bazën e nenit 5.02(i) për normën fikse. Në këtë kontratë, "Norma fikse" nënkupton një normë interesi vjetor të përcaktuar nga Banka në përputhje me parimet e zbatueshme herë pas here, të vendosura nga ana e organeve drejtuese të Bankës për hua me normë interesi fikse e emërtuar në monedhën e transhit dhe mbartëse e të njëjtave afate për shlyerjen e kapitalit dhe interesit.

3.01(2) Transhe me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme

Huamarrësi paguan interesin e shumës së papaguar për t'u paguar të çdo transhi me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme (siç përcaktohet më poshtë) dy herë në vit ose çdo vit në datat përkatëse të shlyerjes të specifikuara në njoftimin përkatës të disbursimit.

Banka i njofton Huamarrësit shtrirjen fikse dhe normën e ndryshueshme brenda dhjetë (10) ditëve pas fillimit të çdo periudhe referimi të shtrirjes fikse me normë të ndryshueshme.

Interesi përlllogaritit, për sa i përket çdo periudhe referimi, me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme mbi bazën e nenit 5.02(ii).

Në këtë kontratë:

"Shtrirje fikse dhe normë e ndryshueshme" nënkupton një normë të ndryshueshme për shtrirje fikse d.m.th., një normë interesi vjetor të barabartë me normën përkatëse ndërbankare plus ose minus shtrirjen, të përcaktuar nga ana e bankës për çdo periudhë vijuese të periudhës së referimit të shtrirjes fikse me normë të ndryshueshme.

"Periudhë referimi të shtrirjes fikse me normë të ndryshueshme" nënkupton çdo periudhë prej gjashtë (6) ose dymbëdhjetë (12) muajsh nga njëra datë shlyerjeje në datën tjetër të shlyerjes përkatëse, me kusht që periudha e parë e referimit të shtrirjes fikse me normë të ndryshueshme të fillojë në datën e disbursimit të transhit.

“Shtrirje” nënkupton shtrirjen përkatëse fikse kundrejt normës përkatëse ndërbankare (që mund të jetë plus ose minus), të përcaktuar nga ana e Bankës dhe të njoftuar Huamarrësit në njoftimin përkatës të disbursimit.

3.02 Interesi mbi shumat të cilave u ka kaluar afati

Pa cenuar nenin 10 dhe me përjashtim të nenit 3.01, interesi rritet/i shtohet çdo shume të papaguar që shlyhet sipas afateve të kësaj kontrate nga data e caktuar për shlyerje deri në datën e shlyerjes me një normë vjetore të barabartë me normën përkatëse ndërbankare plus 2% (200 pikë bazë) dhe shlyhet në përputhje me kërkesën e Bankës. Me qëllim përcaktimit të normës përkatëse ndërbankare lidhur me këtë nen, periudhat përkatëse brenda kuptimit të pasqyrës B duhet të jenë periudha vijuese prej një (1) muaji, që fillojnë në datën e caktuar për shlyerje.

Megjithatë, interesi për një transh me normë fikse vendoset sipas normës vjetore d.m.th. shuma e normës së interesit determinohet sipas nenit 3.01(1) plus 0.25% (25 pikë bazë), nëse norma vjetore në fjalë tejkalon për çdo periudhë të dhënë përkatëse, normën e specifikuar në paragrafin paraprirës.

Nëse shuma a papaguar konsiston në një monedhë ndryshe nga monedha e transhit, norma e mëposhtme vjetore zbatohet, kryesisht norma përkatëse ndërbankare, e cila ruhet përgjithësisht nga Banka për transaksione në atë monedhë plus 2% (200 pikë bazë), përllogaritur në përputhje me praktikën e tregut për një normë të tillë.

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja normale

Huamarrësi shlyen çdo transh me këste në datat e shlyerjes të përcaktuara sipas nenit 5.01 dhe të specifikuar në njoftimin përkatës të disbursimit, në përputhje me afatet e tabelës së likuidimit të paraqitur sipas nenit 2.04.

Çdo tabelë likuidimi hartohet në mënyrë që:

i) shlyerja e një transhi të realizohet:

a) në rastin e një transhi me normë fikse dy herë ose një herë në vit: ose i) me anë të kësteve të barabarta të principalit; ose ii) mbi një bazë vjetore konstante në mënyrë që totali i principalit dhe interesit për t'u paguar për sa i përket transhit, të jetë mundësisht i njëjtë në çdo datë shlyerjeje; dhe

b) në rastin e një transhi me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme, dy herë ose një herë në vit me anë të kësteve të barabarta të principalit; dhe

ii) data e parë e shlyerjes së çdo transhi të jetë një datë shlyerjeje që përkon me ose jo më vonë se data e shlyerjes së parë që ndjek menjëherë përvjetorin e pestë të datës së planifikuar për disbursim të transhit dhe data e fundit e shlyerjes të jetë një datë shlyerjeje që përkon jo më herët se katër (4) vjet dhe jo më vonë se njëzet (20) vjet nga data e planifikuar e disbursimit.

Data e fundit e shlyerjes së një transhi, specifikuar sipas këtij neni 4.01, këtu e tutje quhet “Data e maturimit”.

4.02 Parapagimi vullnetar

4.02(1) Opsioni i parapagimit

Në varësi të neneve 4.02(2) dhe 4.03(3), Huamarrësi mund të parapaguajë plotësisht ose pjesërisht një transh së bashku me interesin rrjedhës me anë të një njoftimi me shkrim të dhënë një (1) muaj përpara (këtu e tutje referuar si “Njoftimi i parapagimit”), ku të specifikohet shuma përkatëse për t'u parapaguar (“Shuma e parapaguar”) dhe data në të cilën Huamarrësi propozon të realizojë parapagimin (“Data e parapagimit”), datë e cila do të jetë data e pagesës për transhin në fjalë.

4.02.2 Dëshmipërblimi i parapagimit

4.02.2 i) Transhi me interes fiks

Për sa i përket çdo shume të parapaguar të një transhi me interes fiks, Huamarrësi i paguan Bankës në datën e parapagimit një dëshmipërblim të barabartë me vlerën aktuale (deri në datën e parapagimit) të shtesës, nëse ekziston:

i) të interesit që do të rrjedhë pas kësaj mbi shumën e parapaguar për periudhën nga data e parapagimit deri në datën e maturimit, nëse shuma në fjalë nuk ishte parapaguar;

ii) mbi interesin që do të rridhte në këtë mënyrë gjatë periudhës në fjalë, nëse ai do të

përllogaritej në bazë të normës së rirreshtimit EIB (siç përcaktohet më poshtë), pa 15 pikë bazë.

Vlera aktuale e përmendur përllogaritet me një normë zbritjeje të barabartë me normën e rirreshtimit EIB të aplikuar për çdo datë shlyerjeje/pagimi.

Në këtë kontratë “Norma e rirreshtimit EIB” nënkupton normën fikse në fuqi një (1) muaj para datës së parapagimit, e cila ka të njëjta afate për shlyerjen e interesit dhe profil të njëjtë shlyerjeje ndaj datës së maturimit, ashtu si shuma e parapaguar.

4.02.2 ii) Transhi me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme

Huamarrësi mund të parapaguajë një transh me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme pa dëmshpërblim në datën përkatëse të shlyerjes.

4.02.3 Mekanizmat e parapagimit

Banka njofton Huamarrësin, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së parapagimit mbi shumën e parapaguar, interesin rrjedhës përkatës, dhe, në rastin e parapagimit të një transhi me normë fikse, mbi dëmshpërblimin për t’u paguar sipas nenit 4.02.2 ose sipas rastit, mbi faktin se asnjë dëmshpërblim nuk do të paguhet.

Jo më vonë se afati i pranimit (siç përcaktohet më poshtë), Huamarrësi njofton Bankën ose:

i) se ai konfirmon njoftimin e parapagimit me kushtet e specifikuar prej Bankës; ose

ii) se ai tërhiqet prej njoftimit të parapagimit.

Nëse Huamarrësi konfirmon sipas pikës i), vendimi ka efekt mbi parapagimin. Në rast se Huamarrësi tërhiqet prej njoftimit të parapagimit ose nuk mund të konfirmojë në kohën e duhur, kjo nuk mund të ndikojë mbi parapagimin. Përveç rasteve më sipër, njoftimi i parapagimit është detyrues dhe i parevokueshëm.

Huamarrësi shoqëron parapagimin me shlyerjen e interesit që rrjedh dhe dëmshpërblimin, nëse ka, mbi shumën e parapaguar.

Për qëllim të këtij neni 4.02 “Afati i pranimit” për një njoftim është:

i) ora 16:00 sipas kohës së Luksemburgut ditën e dorëzimit, nëse njoftimi është dorëzuar brenda orës 14:00 në një ditë zyrtare pune të Luksemburgut; ose

ii) ora 11:00 ditën në vijim, e cila përkon me një ditë zyrtare pune të Luksemburgut, nëse njoftimi është dorëzuar në ditë të tjera pas orës 14:00 sipas kohës së Luksemburgut ose është dorëzuar në një ditë, e cila nuk përkon me një ditë zyrtare pune të Luksemburgut.

4.03 Parapagimi i detyrueshëm

4.03.1 Kushtet e parapagimit

4.03.1 i) Ulja e koston së projektit

Në rastin kur kostoja totale e projektit duhet të zvogëlohet prej të dhënave të deklaruara në përshkrimin (2) në një nivel në të cilin vlera e kredisë e tejkalon 50% të koston totale në fjalë, Banka, nëse dhe duke pasur parasysh se ajo nuk mund të kthejë një përqindje të tillë maksimale duke anuluar një shumë proporcionale të kredisë, mund të kërkojë parapagimin e një pjese të tillë të huasë siç nevojitet për të kthyer përqindjen maksimale në fjalë, duke njoftuar Huamarrësin.

4.03.1 ii) *Pari Passu* në shlyerjen e një huaje tjetër me afat

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht një pjesë ose të gjithë shumën e një huaje tjetër ose çdo borxh apo kredi tjetër financiare në kohën e parapagimit të më shumë se pesë viteve (këtu e tutje referuar si “Hua me afat”), përveçse prej të ardhurave të huasë, e cila ka një afat të paktën të barabartë me afatin që nuk ka mbaruar të huasë së parapaguar, Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë kredinë ose të kërkojë parapagimin e huasë në proporcion të tillë sa mund të mbartë shuma e parapaguar e huasë me afat kundrejt shumës totale të parapaguar të të gjitha huave me afat.

Banka ia drejton njoftimin Huamarrësit brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit sipas nenit 8.02 (ii).

4.03.2 Mekanizmat e parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka sipas nenit 4.03.1 së bashku me çdo interes rrjedhës dhe dëmshpërblim përkatës paguhet në datën e përcaktuar prej saj, e cila përkon jo më pak se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit të kërkesës së Bankës.

Nëse, për më tepër, Huamarrësi parapaguan një transh në një datë ndryshe nga data përkatëse e

shlyerjes, Huamarrësi dëmshpërblen Bankën me një shumë të tillë që sipas Bankës vërtetohet se nevojitet për të kompensuar atë për marrjen e fondeve jashtë datës përkatëse të shlyerjes.

4.03.3 Aplikimi i parapagimeve të pjesshme

Nëse Huamarrësi parapaguan pjesërisht një transh, shuma e parapagimit aplikohet pro rata/proporcionalisht ose, kur ekziston opsioni, me anë të urdhrimit të anasjellë të maturimit për çdo këst të papaguar.

Nëse Banka kërkon një parapagim të pjesshëm të huasë, Huamarrësi, në pajtim me kërkesën, duke njoftuar Bankën brenda pesë (5) ditëve zyrtare të punës së Luksemburgut nga marrja e kërkesës së saj, mund të zgjedhë transhet për t'u parapaguar dhe mund të ushtrojë opsionin për të aplikuar shumat e parapaguara.

Ky nen 4 nuk cenon nenin 10.

Neni 5 Pagesat

5.01 Përcaktimi i datës së pagesës

Në këtë kontratë "Datë pagese" nënkupton

i) për një transh me normë fikse, datat vjetore ose gjashtëmujore të çdo viti, të specifikuar në njoftimin e disbursimit të çdo viti; dhe

ii) për një transh me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme, datat që përkojnë në intervale vjetore dhe gjashtëmujore nga data e planifikuar e disbursimit deri në datën e maturimit, përjashtojt rastet kur një datë e tillë nuk përkon me një ditë zyrtare pune të Luksemburgut, atëherë ajo nënkupton:

i) për një transh me normë fikse, ditën përkatëse zyrtare pasuese pa përshtatur interesin përkatës sipas nenit 3.01;

ii) për një transh me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme, dita vijuese, nëse ekziston, e atij muaji kalendarik i cili përkon me një ditë përkatëse zyrtare ose, kur nuk përkon me një ditë të tillë, dita më e afërt paraprirëse e cila përkon në një ditë përkatëse zyrtare me përshtatjen korresponduese të interesit përkatës sipas nenit 3.01; dhe

"Ditë përkatëse zyrtare" nënkupton:

i) për euro, një ditë në të cilën operon sistemi i shlyerjes Transeuropean Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer (TARGET); dhe

ii) Për çdo monedhë tjetër, një ditë në të cilën Bankat janë hapur për të kryer shërbime tregtare normale në qendrat kryesore financiare të vendit të monedhës në fjalë.

5.02 Marrëveshja e numërimit të ditëve

Çdo shumë për t'u paguar në formë interesi, dëmshpërblimi ose pagese prej Huamarrësit sipas kësaj kontrate dhe e përllogaritur për sa i përket një pjese të vitit, përcaktohet në bazë të marrëveshjeve përkatëse të mëposhtme:

i) për një transh me normë fikse, një vit me treqind e gjashtëdhjetë (360) ditë dhe një muaj me tridhjetë (30) ditë; dhe

ii) për një transh me shtrirje fikse dhe normë të ndryshueshme, një vit me treqind e gjashtëdhjetë (360) ditë, (por treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë (të pandryshueshme) për GBP/Sterling) dhe numrin e ditëve që kanë kaluar.

5.03 Koha dhe vendi i shlyerjes

Çdo shumë përveç asaj të interesit, dëmshpërblimit dhe principalit shlyhet brenda shtatë (7) ditëve nga marrja nga ana e Huamarrësit të kërkesës së Bankës.

Secila shumë për t'u shlyer nga ana e Huamarrësit, sipas kësaj kontrate paguhet në llogarinë respektive të njoftuar prej Bankës. Banka përcakton llogarinë jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës përkatëse të pagesës së parë nga ana e Huamarrësit dhe njofton çdo ndryshim llogarie jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së pagesës së parë për të cilën ndryshimi aplikohet. Kjo periudhë njoftimi nuk aplikohet në rastin e pagesës sipas nenit 10.

Një shumë për t'u paguar nga Huamarrësi gjykohet e paguar kur Banka e merr atë.

Neni 6 Angazhime

6.01 Përdorimi i huasë dhe fondeve të tjera në dispozicion

Huamarrësi përdor të ardhurat e huasë vetëm për realizimin e projektit.

Huamarrësi siguron që Livruesi të ketë në dispozicion fondet e tjera të renditura në përshkrimin (2) dhe që fondet në fjalë të përdoren, në masën e kërkuar, për financimin e projektit.

6.02 Zbatimi dhe përfundimi i projektit

Huamarrësi detyron Livruesin ta realizojë projektin në përputhje me përshkrimin teknik dhe ta përfundojë atë brenda datës përfundimtare të specifikuar në përshkrim sipas modifikimeve të herëpashershme me miratimin e Bankës.

6.03 Kostoja e shtuar e projektit

Nëse kostoja totale e projektit tejkalon shifrat e përcaktuara në përshkrimin (2), Huamarrësi dhe Livruesi përfitojnë fonde për të financuar koston e tepërt pa këkesë për ndihmë nga Banka, në mënyrë që të bëhet i mundur përfundimi i projektit në përputhje me përshkrimin teknik. Planet e Huamarrësit dhe/ose Livruesit për të financuar koston e tepërt i dorëzohen në kohë Bankës për miratim.

6.04 Procedura e prokurimit

Huamarrësi garanton Bankën dhe merr përsipër që të gjitha punimet, mallrat, pajisjet dhe shërbimet për projektin janë dhe do të urdhërohen, blihen dhe sigurohen nëpërmjet tenderit të hapur ndërkombëtar ose procedurave të tjera të pranueshme të prokurimit që pajtohen me gjykimin e Bankës, me politikën e saj të përshkruar në guidën e prokurimit në fuqi në datën e kësaj kontrate.

6.05 Vazhdimi me sipërmarrjet e projektit

Për sa kohë huaja mbetet e papaguar, Huamarrësi siguron ose bën që Livruesi të sigurojë:

1. Mirëmbajtja: mirëmban, riparon, realizon kontrollin e përgjithshëm dhe restauron të gjitha punimet dhe pasuritë që janë pjesë e projektit siç kërkohet për t'i mbajtur ato në gjendje të mirë pune dhe për të siguruar fonde të mjaftueshme për qëllimet e përmendura.

2. Asetet e projektit: përveçse kur Banka ka dhënë pëlqimin e saj paraprak me shkrim, ajo ruan të drejtën dhe pronësinë ndaj të gjitha ose kryesisht të gjitha asetëve që përbëjnë projektin ose, sipas rastit, zhvendos dhe rivendos asetet në fjalë dhe mirëmban projektin në operim të vazhdueshëm, në përputhje me qëllimin e saj origjinal; me kusht që Banka mund të refuzojë pëlqimin e saj, vetëm atje ku veprimi i propozuar do të cenonte interesat e saj si kreditore ndaj Huamarrësit ose do të bënte projektin të papërshtatshëm për t'u financuar prej saj sipas statutit, ose sipas nenit 267 të Traktatit të Romës.

3. Siguracioni: të sigurojë të gjitha punimet dhe pasuritë që janë pjesë e projektit me siguracion të klasit të parë, në përputhje me praktikën industriale përkatëse më gjithëpërfshirëse.

4. Të drejtat dhe lejet: mban në fuqi të gjitha të drejtat e mënyrës dhe përdorimit dhe të gjitha lejet e nevojshme për ushtrimin dhe operimin e projektit.

5. Mjedisi:

a) Zbaton dhe operon projektin në përputhje me ligjet përkatëse të Bashkimit Europian në nivelin e zbatimit nga ligjet e Republikës së Shqipërisë ose të specifikuar nga Banka para datës së kësaj kontrate, si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të aplikueshme, objektivi kryesor i të cilave mbetet mbrojtja, ruajtja ose përmirësimi i mjedisit; për qëllim të së cilës "Mjedisi" nënkupton si më poshtë: a) kushtet e jetës së njerëzve; b) florën dhe faunën; c) tokën, ujin, ajrin, klimën dhe peizazhin; dhe d) trashëgiminë kulturore dhe mjedisin e krijuar; dhe përfshin kushtet e punës së punonjësve të angazhuar në projekt dhe efektet e tij sociale.

Megjithatë, pajtueshmëria me ligjin kombëtar të Huamarrësit konsiderohet si pajtueshmëri me ligjin e Bashkimit Europian përveçse ose deri në momentin që komisioni ndërmerr masa ku shpallet se ligji kombëtar nuk zëvendëson saktësisht ligjin e Bashkimit Europian ose Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane vendos për këtë çështje.

b) Të përfitojë dhe ruajë të gjitha miratimet nga dhe të autorizuara prej autoriteteve kompetente të mjedisit të Huamarrësit, të nevojshme për marrjen e porosive.

c) Të sigurojë që projekti nuk ka efekte të rëndësishme mbi ndonjë zonë nën mbrojtjen natyrore.

d) Të sigurojë që asnjë material ose substancë, të cilat mund të kenë efekte negative mbi mjedisin nuk përdoret ose hidhet gjatë ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së projektit.

e) Të kryejë të gjitha punimet e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit mbi projektin, të cilat mund të kërkohen nga ana e autoriteteve kompetente të mjedisit.

6. Ligjshmëria e përgjithshme: të ushtrorë dhe operorë projektin në përputhje me parimet e ligjit të Bashkimit Europian të aplikueshëm drejtpërsëdrejti për Livruesin dhe projektin, sipas zbatimit të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

6.06 Ekipi i zbatimit të projektit

Huamarrësi ruan ekipin ekzistues të zbatimit të projektit ose një organizim tjetër me funksion të njëjtë të pranueshëm për Bankën me nivel personeli kompetent të përshtatshëm dhe përforcon ekipin sipas nevojës me konsulentë me përvojë.

6.07 Angazhimi i integritetit

Huamarrësi garanton dhe merr përsipër se ai dhe asnjë person i njohur prej tij nuk kanë kryer asnjë prej akteve të mëposhtme dhe se ai dhe çdo person tjetër me pëlqimin apo dijeninë e tij të mëparshme, nuk do të kryejnë akte të tilla d.m.th.:

i) ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi i ndonjë avantazhi të papërshtatshëm për të ndikuar në veprimin e ndonjë personi që ka post ose funksion publik, ose drejtor apo punonjës i një autoriteti publik, ose ndërmarrjeje publike, ose zyrtar i një organizate ndërkombëtare publike në lidhje me ndonjë proces prokurimi, ose ekzekutimin e ndonjë kontrate për sa i përket atyre elementeve të projektit që jepen në përshkrimin teknik; ose

ii) çdo akt që ndikon në formë të papërshtatshme ose synon të ndikojë në këtë formë në procesin e prokurimit, ose zbatimin e projektit në dëm të Huamarrësit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet tenderuesve.

Për këtë qëllim, marrja dijëni e ndonjë Ministri të Huamarrësit, Sekretari Shteti të Huamarrësit, asistentministri të Huamarrësit, këshilltar të Ministrisë të Huamarrësit, menaxherit ose anëtar stafi të njësisë së zbatimit të projektit, do të çmohet si marrje dijëni e Huamarrësit. Ky i fundit ndërmerr ta informojë Bankën, nëse ajo duhet të vihet në dijeni të ndonjë fakti ose informacioni sugjerues të komisionit për ndonjë akt të tillë.

6.08 Ndërmarrje të tjera

i) Pas përfundimit të ndërtimit dhe hapjes së rrugës ndaj trafikut, Huamarrësi do të bëjë që Livruesi të kryejë një audit sigurie trafiku, me qëllim që të garantojë funksionim të mjaftueshëm të masave të planifikuara të sigurisë;

ii) Pas përfundimit të projektit, Huamarrësi do të bëjë që Livruesi t'i ofrojë Bankës një rishikim të suksesit të masave të propozuara në parandalimin e kompleksëve të reja përgjatë rrugës afër lagunës së Nartës dhe kufizimin e hyrjes në autostradën e shpejtë në përgjithësi;

iii) Huamarrësi do të bëjë që Livruesi të adoptojë një grup standardesh të projektit të rrugës, zhvillimi i të cilave duhet të merret parasysh në vlerësimin nga ana e Bankës të projekteve të ardhshme;

iv) Huamarrësi do të bëjë që Livruesi të krijojë një kuadër për përfshirjen e auditeve të sigurisë së trafikut në procedurat kombëtare të planifikimit dhe standardet e rrugëve; dhe

v) Huamarrësi do të bëjë që Livruesi të zbatojë në faza një sistem të njohur menaxhimi në nivel ndërkombëtar të urave dhe trotuareve për rrjetin rrugor. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi të marrë këshillim ekspertësh dhe të përcaktojë politikat e tij, sistemet e tij të propozuara dhe agjencitë që duhet të zbatojnë këto sisteme. Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi do të përpiqet të zbatojë sisteme tërësisht funksionale, sisteme të integruara të menaxhimit të urave dhe trotuareve sipas një grafiku që duhet të bihet dakord me Bankën. Një pjesë mjaft e rëndësishme e këtyre sistemeve do të jetë baza gjithëpërfshirëse e të dhënave, e cila do të përditësohet në intervale të rregullta dhe të shpeshta. Huamarrësi do të bëjë që Livruesi të sigurojë që agjencitë e përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit të urave dhe trotuareve, të jenë të pajisura mjaftueshëm me personel, me një numër të përshtatshëm profesionistësh të trajnuar në nivelin e duhur.

Neni 7

Pari Passu

Nëse më tej, Huamarrësi duhet t'i japë një pale të tretë garanci për përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të borxhit të jashtëm ose ndonjë preferencial, ose prioritet në këtë drejtim, Huamarrësi do ta informojë Bankën në lidhje me këtë dhe nëse kjo kërkohet nga Banka, do t'i japë Bankës garanci të barasvlefshme për përmbushjen e detyrimeve të tij si më poshtë ose do t'i japë Bankës preferencial, ose prioritet të barasvlefshëm. Huamarrësi pohon se asnjë garanci, preferencë ose prioritet i tillë nuk ekziston

aktualisht.

Asgjë në seksionin e mësipërm nuk do të zbatohet: i) ndaj ndonjë pengese për garanci pagese të shitësit ose barre tjetër mbi tokën apo asetet e tjera, ku kjo barrë siguron vetëm çmimin e blerjes ose ndonjë kredi, duke pasur afat jo më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj, të siguruar për ta financuar atë; ose ii) ndaj ndonjë garancie mbi fondet e krijuara për të marrë kredi afatshkurtër.

Neni 8

Informacioni dhe vizitat

8.01 Informacion në lidhje me projektin

Huamarrësi do të bëjë që Livruesi:

i) t'i japë Bankës: a) informacion në përmbajtje dhe në formë dhe në të gjitha periudhat, të specifikuar në pasqyrën A.2 ose ndryshe siç bihet dakord herë pas here nga Palët e kësaj kontrate; dhe b) çdo informacion i tillë ose dokument i mëtejshëm në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, operimin dhe ndikimin mjedisor të projektit ose për projektin, siç mund ta kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme, gjithmonë me kusht që nëse ky informacion ose dokument nuk i është dhënë Bankës në kohë dhe Huamarrësi nuk korrigjon gabimin brenda një periudhe të arsyeshme kohore të përcaktuar nga Banka me shkrim, Banka mund të ndreqë defektin në shkallën e mundshme duke përdorur stafin e saj ose ndonjë konsulent, ose palë tjetër të tretë, me shpenzimet e Huamarrësit dhe Huamarrësi do t'i japë këtyre personave të gjithë asistencën e nevojshme për këtë qëllim;

ii) të ruajë në një vendndodhje të vetme për inspektim gjatë gjashtë viteve nga përfundimi i çdo kontrate të financuar me anë të huasë, kushtet e plota të vetë kontratës, si dhe të gjitha dokumentet materiale që kanë lidhje me procesin e prokurimit dhe për ekzekutimin e kontratës dhe të prokurojë që Banka të mund të inspektojë dokumentet kontraktuale që kontraktori është i detyruar të mbajë sipas kontratës së tij të furnizimit;

iii) të paraqesë për miratimin pa vonesë nga ana e Bankës të çdo ndryshimi material në çmim, projekt, plane, orare ose pasqyrë shpenzimesh për projektin në lidhje me informacionin e dhënë Bankës para nënshkrimit të kësaj kontrate;

iv) t'i japë Bankës çdo vit, nëse kërkohet, një listë të politikave në fuqi që mbulojnë pronën e siguruar që përbëjnë pjesë të projektit së bashku me konfirmimin e pagesës së kësteve aktuale të sigurimit; dhe

v) të informojë menjëherë Bankën: a) në lidhje me ndonjë çështje gjyqësore materiale që ka filluar ose përbën kërcënim kundër saj në lidhje me çështjet mjedisore, ose çështje të tjera që cenojnë projektin; ose b) çdo fakt ose ngjarje për të cilën ka dijeni Huamarrësi, që mund të cenojë në mënyrë të konsiderueshme kushtet e ekzekutimit ose operimit të projektit.

8.02 Informacion në lidhje me Huamarrësin

Huamarrësi do të informojë menjëherë Bankën:

i) në lidhje me ndonjë fakt që e detyron atë dhe çdo kërkesë të bërë ndaj tij ose për të parapaguar për shkak të mospagimit, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë hua që i jepet atij nga një palë e tretë, ose për të përmbushur për këtë arsye para periudhës së maturitetit ndonjë borxh që lind nga një transaksion financiar, ose pjesë e tij;

ii) në lidhje me çdo vendim të marrë nga ai për të bërë parapagim të një huaje me afat;

iii) në lidhje me çdo synim mbi pjesën e tij për të hequr dorë nga pronësia e ndonjë pjese kryesore të projektit; dhe

iv) përgjithësisht për ndonjë fakt ose ngjarje që mund të pengojë plotësimin e ndonjë detyrimi të Huamarrësit sipas kësaj kontrate.

8.03 Vizitat nga Banka dhe dokumentet

Për sa kohë që huaja është e papaguar, Huamarrësi do të garantojë që personat e caktuar nga Banka që mund të shoqërohen nga përfaqësues të Gjykatës Europiane të Auditorëve të Komunitetit Europian ose ndonjë organ, ose institucion kompetent të Komunitetit, do të lejohen të vizitojnë mjediset, instalimet dhe punimet që përbëjnë projektin dhe të kryejnë këto kontrole sipas dëshirës. Për këtë qëllim, Huamarrësi do t'u japë këtyre personave dhe përfaqësuesve ose do të sigurojë që atyre t'u jepet e gjithë asistencë e nevojshme.

Huamarrësi pohon se Banka mund të jetë e detyruar t'ia bëjë të njohura këto dokumente në lidhje me Huamarrësin dhe projektin ndonjë organi ose institucioni kompetent të Komunitetit, siç janë të

nevojshme për përmbushjen e detyrës së saj në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Europian.

8.04 Hetimet dhe informacioni

Huamarrësi ndërmerr:

i) të marrë këto masa, siç mund ta kërkojë Banka, në mënyrë të arsyeshme për të hetuar dhe/ose përfunduar dhe/ose ndërmarrë për të çuar në hetimin dhe/ose përfundimin e ndonjë akti të supozuar, ose të dyshuar të natyrës së përshkruar në nenin 6.07;

ii) ta informojë Bankën në lidhje me masat e marra për të kërkuar dëmet nga personat përgjegjës për humbjen që rezulton nga ky akt;

iii) të lehtësojë dhe/ose sigurojë lehtësimin e ndonjë hetimi që Banka mund të bëjë në lidhje me këtë akt.

Për sa kohë që Huamarrësi nuk specifikon ndryshe me shkrim për Bankën, Huamarrësi do të jetë përgjegjës për kontaktet me Bankën për qëllimet e nenit 6.07.

Neni 9

Detyrimet dhe shpenzimet

9.01 Taksat, tatimet dhe detyrimet

Huamarrësi do të përballojë të gjitha detyrimet e shkëmbimit, transferimit, Bankës apo detyrime profesionale jashtë xhepit që lindin gjatë ekzekutimit ose zbatimit të kësaj kontrate, ose ndonjë dokumenti të ngjashëm dhe në krijimin e kësaj garancie për huanë, si dhe shpenzimet e Bankës sipas nenit 8.04.

Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesin, zhdëmtimin dhe shumën të tjera bruto të pagueshme sipas kësaj kontrate, pa zbritjen e asnjë takse kombëtare ose lokale, me kusht që nëse Huamarrësi është i detyruar ta bëjë këtë zbritje, ai do të bëjë llogaritjen për pagesën për Bankën në mënyrë që pas zbritjes, shumën neto e marrë nga Banka të jetë e barasvlefshme me shumën e paguar.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi do të përballojë të gjitha detyrimet dhe shpenzimet, duke përfshirë shpenzimet e shkëmbimit, transferimit, Bankës, shpenzimet profesionale të bëra në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e kësaj kontrate ose ndonjë dokumenti të ngjashëm, duke përfshirë çdo amendim ndaj saj dhe në krijimin, menaxhimin dhe zbatimin e ndonjë garancie për huanë, nëse ka, si dhe çdo shpenzim të Bankës sipas nenit 8.04.

Banka do të japë mbështetje të dokumentuar për çdo detyrim ose shpenzim të tillë shtatë (7) ditë para se kërkesës së saj për pagesë t'i kalojë afati.

Neni 10

Parapagesa pas një rasti mospagese

10.01 E drejta për të kërkuar shlyerje

Huamarrësi do të shlyejë huanë ose ndonjë pjesë të saj menjëherë, së bashku me interesin e shtuar mbi të, pas kërkesës me shkrim që bëhet për këtë qëllim nga Banka, në përputhje me kushtet e mëposhtme.

10.01.1. Kërkesa e menjëhershme

Banka mund ta bëjë këtë kërkesë menjëherë:

i) nëse Huamarrësi nuk arrin që në datën e duhur të shlyejë ndonjë pjesë të huasë, të paguajë interes mbi të ose të bëjë ndonjë pagesë tjetër për Bankën, siç parashikohet në këtë dokument;

ii) nëse Huamarrësi dështon në përmbushjen e ndonjë detyrimi financiar në lidhje me huanë (të ndryshme nga huaja) të bërë për të nga Banka dhe nëse, pas mosplotësimit të kësaj, Huamarrësit i kërkohet të parapaguajë ndonjë hua tjetër ose të shlyejë para periudhës së maturitetit ndonjë borxh që lind nga një transaksion financiar;

iii) nëse, pas mosarritjes nga ana e Huamarrësit të shlyerjes së ndonjë detyrimi në lidhje me ndonjë hua të referuar në pikën 2 ose ndonjë granti të dhënë atij nga Bashkimi Europian, e drejta e

Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e asaj huaje, ose ndonjë granti të tillë, tërësisht ose pjesërisht, do të ishte anuluar ose përfunduar, ose nëse ajo hua, ose ky grant do të ishin bërë të shlyeshme sipas kushteve të tij;

iv) përgjithësisht, nëse ndodh diçka që ka të ngjarë të rrezikojë njoftimin e huasë ose të cenojë rëndë ndonjë garanci për këtë qëllim; ose

v) nëse ndonjë informacion ose dokument i dhënë Bankës, nga ose në emër të Huamarrësit në lidhje me negocimin e kësaj kontrate, ose gjatë kohëzgjatjes së tyre, duket të ketë pasur në përmbajtje një keqdeklarim material të faktit, në rastin kur jepet.

10.01.2 Kërkesa pas njoftimit për kompensim

Banka, gjithashtu mund të bëjë këtë kërkesë, pasi çështja nuk është rregulluar sipas pëlqimit të Bankës brenda një periudhe kohore të arsyeshme të specifikuar në një shënim të dhënë nga Banka për Huamarrësin:

i) nëse Huamarrësi nuk arrin të pajtohet me ndonjë detyrim material sipas kësaj kontrate që nuk është detyrim i përmendur në nenin 10.01.1 i); ose

ii) nëse ndonjë fakt i deklaruar në pikat përkatëse ndryshon materialisht dhe nuk është rregulluar materialisht dhe, nëse ndryshimi cenon interesat e Bankës si huadhënëse për Huamarrësin ose cenon rëndë zbatimin ose operimin e projektit.

10.02 Të drejta të tjera në ligj

Neni 10.01 nuk do të kufizojë asnjë të drejtë tjetër të Bankës në ligj për të kërkuar parapagim të huasë.

10.03 Zhdëmtimi

10.03.1 Transhet me norma fikse

Në rast të kërkesës sipas nenit 10.01 në lidhje me ndonjë normë fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me interesin e shtuar mbi të dhe me një shumë të llogaritur në përputhje me nenin 4.02.2 i) mbi ndonjë shumë që është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme. Kjo shumë do të shtohet nga data e kërkuar për pagim, specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës dhe të llogaritet mbi bazën që parapagimi të bëhet në datën e specifikuar në këtë mënyrë.

10.03.2 Transhet e periudhës së referencës me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël

Në rast të kërkesës sipas nenit 10.01 në lidhje me një transh të periudhës së referencës me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me një shumë të barabartë me vlerën aktuale të 0.15 % (15 pikë bazë) në vit, të llogaritur dhe të shtuar mbi shumën e kërkueshme për t'u parapaguar në të njëjtën mënyrë siç do të llogaritej interesi dhe do të ishte shtuar, nëse ajo shumë do të kishte mbetur e papaguar sipas programit fillestar të pagesës në këste të transhit.

Kjo vlerë aktuale do të përcaktohet duke përdorur një normë zbritjeje, të aplikuar për çdo datë përkatëse pagimi. Norma e zbritjes do të jetë norma fikse e zbatueshme një (1) muaj para datës së parapagimit dhe që ka të njëjtat kushte për pagimin e interesit dhe të njëjtin afat për datën e maturimit, si shuma që duhet parapaguar.

10.03.3 Të përgjithshme

Shumat e kërkueshme nga Huamarrësi, sipas këtij neni 10.03, do të jenë të pagueshme në datën e parapagimit të specifikuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Mosheqja dorë

Asnjë pamundësi ose vonesë nga Banka në ushtrimin e ndonjë prej të drejtave të saj, sipas këtij neni 10, nuk do të interpretohet si heqje, dorë nga kjo e drejtë.

10.05 Aplikimi i shumave të marra

Shumat e marra nga Banka pas një kërkesë, sipas nenit 10.01, do të aplikohen së pari në pagesën e shpenzimeve, (nëse ka), interesit dhe zhdëmtimeve dhe, së dyti në uljen e kësteve të papaguara në rend të anasjellë të maturitetit. Banka mund të aplikojë shumat e marra ndërmjet transheve sipas zgjedhjes së saj.

Neni 11

Gjuha, ligji dhe juridiksioni

11.01 Gjuha

Çdo dokument, njoftim ose komunikim i bërë ndërmjet Palëve më poshtë do të bëhet në gjuhën anglisht ose do të shoqërohet nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën anglisht.

11.02 Ligji rregullues

Kjo kontratë do të rregullohet nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.03 Juridiksioni

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do t'i paraqiten Gjykatës së Drejtësisë të Komunitetit Europian.

Në këtë mënyrë, Palët e kësaj kontrate heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e asaj gjykate. Çdo vendim i Gjykatës i dhënë sipas këtij neni 11.03 do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë për Palët, pa kufizim ose rezervim.

11.04 Provat e shumave të kërkueshme

Në çdo veprim ligjor që lind nga kjo kontratë, vërtetimi i Bankës për ndonjë shumë të kërkueshme nga Banka, sipas kësaj kontrate, do të jetë provë *prima facie* e kësaj shume.

Neni 12

Dispozita përfundimtare

12.01 Njoftimet për çdo palë

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna më poshtë të drejtuara ndaj çdo Pale të kësaj kontrate, do të jenë me shkrim dhe do të dërgohen në adresën e tyre të përcaktuar më poshtë ose në adresë tjetër, siç njëra palë e njofton paraprakisht tjetrën me shkrim:

Për Bankën 100 boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

Për Huamarrësin "Dëshmorët e Kombit", nr.1

Tirana

Albania

Për Livruesin "Sami Frashëri", nr.33

Tirana

Albania

12.02 Forma e njoftimit

Njoftimet dhe komunikimet e tjera për të cilat janë përcaktuar periudha fikse në këtë kontratë ose që vetë ato përcaktojnë periudha të detyrueshme mbi marrësin, do të jepen dorazi, me postë rekomande, faks ose mjete të tjera të transmetimit që sigurojnë provën e marrjes nga marrësi. Data e regjistrimit ose sipas rastit, data e deklaruar e marrjes së transmetimit, do të jetë përfundimtare për përcaktimin e një periudhe.

Njoftimet e nxjerra nga Huamarrësi sipas ndonjë kushti të kësaj kontrate, kur kërkohen nga Banka, do t'i jepen Bankës së bashku me prova të mjaftueshme të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar këtë njoftim në emër të Huamarrësit dhe modelin e vërtetuar të firmës së këtij personi, ose këtyre personave.

12.03 Pasqyrat dhe programet

Pasqyrat dhe programet e mëposhtme përbëjnë pjesë të kësaj kontrate:

Pasqyra A Përshkrimi teknik dhe detyrat e informacionit

Pasqyra B Përkufizimi i EURIBOR dhe LIBOR

Pasqyra C Forma e kërkesës së disbursimit (Neni 1.02.2)

Pasqyra D Vërtetimi i Huamarrësit.

Në dëshmi sa më sipër, Palët kanë nënshkruar këtë kontratë që duhet të shënohet me iniciale në secilën faqe në emër të tyre dhe duhet të ekzekutohet në katër (4) origjinale në gjuhën anglisht si më poshtë.

Tirana ,/ 2007

NËNShkruar për dhe në emër të

NËNShkruar për dhe në emër të

PASQYRA A

A.1 PËRSHKRIMI TEKNIK

Qëllimi, vendndodhja:

Projekti ka lidhje me ndërtimin e një autostrade të shpejtë me korsi 2x2 midis Levanit dhe Vlorës, me një gjatësi totale prej 24 kilometrash.

Projekti, gjithashtu do të përfshijë përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe auditeve të sigurisë së rrugëve për projektet e ardhshme të përfshira në programin e investimit të rrugëve dhe të shqyrtuara për financimin EIB.

Standardet e projektit:

Baza e projektit e adoptuar për seksionin rrugor Levan-Vlorë është në përputhje me standardin rrugor italian "Norme Sulle Caratteristiche Geometriche Delle Strade Extraurbane". Po këto standarde adoptohen, gjithashtu në projektin e detajuar për kriteret e mbingritjes së trasesë, parametrat e kthesave të kalimit dhe planet urbanistike të kryqëzimeve.

D.M.5/11/2001 përcakton në rrugët e tipit B dimensionet e mëposhtme për elementet rrugorë (zgjidhja bazë 2 + 2, gjerësia e përgjithshme 22 metra):

- 2 korsi me gjerësi 3.75 metra në secilin drejtim;
- kufiri qendror i gjerësisë 3.50 metra, i përbërë prej ndarësit të trafikut me gjerësi 2.50 metra dhe anët e xhadesë në qendër me gjerësi 0.50 metra; pista të rrugëve nga jashtë gjerësisë prej 1.75 metra.

Kryqëzimet:

Kryqëzimi me rrugën Levan-Tepelenë (km 19+500)

Do të zbatohet një kryqëzim i përkohshëm me pjerrësi, me një devijim të rrugës ekzistuese. Ky kryqëzim i përkohshëm do të projektohet për të lejuar për ndërtimin e ardhshëm të rrugës Levan-Tepelenë përmirësimin e rrugës, duke shmangur kështu interferencën e ardhshme me trafikun.

Për hartimin e skemës përfundimtare, një rrugë me kthesa prej 60 metrash në diametër, me gjashtë lega është parashikuar për të siguruar lidhje për rrugët lokale, duke siguruar hyrje në Levan dhe një kryqëzim me rrugën e re të propozuar nga Levani në Tepelenë.

Kryqëzimi me rrugën për në Novoselë (km 28+350)

Hartimi i skemës përfundimtare parashikon një rrugë me kthesa prej 50 metrash në diametër, me katër lega për të lidhur rrugën për në Novoselë.

Kryqëzimi me rrugën për në Panaja (km 32 + 226)

Ky kryqëzim propozon një rrugë me kthesa prej 50 metrash në diametër, me katër lega për të siguruar hyrje në rrugën për në Panaja dhe punimet kripore në Skrofotina.

Kryqëzimi me rrugën ekzistuese në Vlorë (km 43+503)

Kryqëzimi, siç është projektuar, është një rrugë me kthesa prej 50 metrash në diametër, me katër lega që lidhet me rrjetin rrugor, duke siguruar hyrje për në port dhe në zonën industriale të Vlorës.

Të tjera:
 Sistemet e ndriçimit do të sigurohen për të gjitha tipet e kryqëzimit (kryqëzime T, rrugët me kthesa, kryqëzimet etj.).
 Barrierat e sigurisë së rrugëve për përdorim në rezervën qendrore dhe në anët e rrugës së transportit.
 Vendndalimet në drejtim të qarkullimit të trafikut propozohen të vendosen në pjesën e jashtme të anës së xhadesë afërsisht çdo kilometër dhe parashikohen të kenë dimensionet e mëposhtme:
 - Gjerësia e tërthortë: 3.00 metra +0.50 metra ana e xhadesë;
 - Gjatësia: 25.00 metra, me hyrje dhe dalje në formë konike, secila me gjatësi 20.00 metra.
 Strukturat kryesore: urat dhe urat-rrugë
 - Ura-rrugë "FERRASI" km 21+305-21+690 (gjatësi totale prej 385 metrash);
 - Ura e "VJOSËS" km 22+600-22 +730 (gjatësi totale prej 130 metrash).
 Grafiku:
 Pritet që punimet e ndërtimit të përhershëm të fillojnë në tetor 2007 dhe projekti të përfundojë në fund të dhjetorit 2010.

A.2 INFORMACION I PROJEKTIT QË DUHET T'I DËRGOHET BANKËS DHE METODA E TRANSMETIMIT

A.2.1 Shpërndarja e informacionit: përcaktimi i personit përgjegjës
 Informacioni i mëposhtëm duhet t'i dërgohet Bankës nën përgjegjësinë e:

Firma	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
Personi i kontaktit	Z. Ylli Gjoni
Pozicioni	Drejtor
Funksioni/departamenti	Ekipi i zbatimit të projektit
Adresa	Rr "Sami Frashëri", nr 33, Tiranë, Albania
Telefon	+355 4 259897
Faks	+355 4 233711
E- mail	ylli73@yahoo.com

Personi i lartpërmendur i kontaktit është kontakti përgjegjës për kohën në vazhdim. Huamarrësi do të informojë menjëherë EIB në rast ndryshimi.

A.2.2 Informacion mbi subjekte specifike

Huamarrësi do t'i japë Bankës informacionin e mëposhtëm maksimumi në afatin e specifikuar më poshtë:

Dokument/informacion	Afati
Raporte të veçanta në rast të situatave ose ngjarjeve të paparashikuara, që mund të shkaktajnë ndërprerjen e kontratave të punës ose shërbimit	Jo më vonë se 1 muaj pas shfaqjes së situatës ose ngjarjes së paparashikuar

A.2.3 Informacion mbi përfundimin e projektit

Huamarrësi do t'i japë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi ecurinë e projektit gjatë zbatimit maksimumi në afatin e specifikuar më poshtë.

Dokumenti/informacioni	Afati	Shpeshësia e raportimit
Raportet e ecurisë së projektit	Jo më vonë se 30 ditë pas fundit të çdo periudhe raportimi	Tremujore
- një përditësim i shkurtër mbi përshkrimin teknik, duke shpjeguar arsyet për ndryshimet e rëndësishme kundrejt objektit fillestar;		
- përditësim mbi datën e përfundimit të secilit prej		

komponentëve kryesorë të projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë vonesë të mundshme;

- përditësim mbi koston e projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë rritje të mundshme të koston kundrejt koston fillestare të llogaritur;

- një përshkrim të ndonjë çështjeje kryesore me ndikim në mjedis;

- përditësim mbi procedurat e prokurimit;

- përditësim mbi kërkesën ose përdorimin e projektit dhe komentet përkatëse;

- çdo çështje të rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo rrezik thelbësor, që mund të cenojë operimin e projektit;

- çdo masë ligjore në lidhje me projektin, që mund të jetë e vazhdueshme.

Raportet e ecurisë së projektit duhet të jenë të qarta dhe precize, të përgatiten nga njësia e zbatimit të projektit dhe të mos përmbajnë më shumë sesa 4-5 faqe teksti kryesor. Një model duhet të bihet dakord me Bankën.

A.2.4 Informacion mbi fundin e punimeve dhe viti i parë i operimit

Huamarrësi do t'i japë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi përfundimin e projektit dhe operimin fillestar maksimumi në afatin e specifikuar më poshtë.

Dokumenti/informacioni

Raporti i përfundimit të projektit, duke përfshirë:

- një përshkrim të shkurtër të karakteristikave teknike të projektit të përfunduar, duke shpjeguar arsyet për ndonjë ndryshim thelbësor;

- datën e përfundimit të secilit prej komponentëve kryesorë të projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë vonesë të mundshme;

- koston përfundimtare të projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë rritje të mundshme kostoje kundrejt koston fillestare të llogaritur;

- numrin e vendeve të reja të punës të krijuara nga projekti: punët si gjatë zbatimit dhe vendet e reja të përhershme të krijuara të punës;

- një përshkrim të ndonjë çështjeje kryesore me ndikim në mjedis;

- si pjesë e kërkesave të raportimit të Livruesit kundrejt Bankës pas përfundimit të projektit, bëhet një rishikim i suksesit me të cilin masat e propozuara për parandalimin e komplekseve të reja përgjatë rrugës afër lagunës së Nartës dhe hyrjes së kufizuar në ngushticën e rrugës, kanë qenë të suksesshme ose në forma të tjera;

- përditësim mbi procedurat e prokurimit;

- përditësim mbi kërkesën e projektit ose përdorimin dhe komentet;

- çdo çështje të rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo rrezik thelbësor, që mund të cenojë operimin e projektit;

- çdo masë ligjore në lidhje me projektin, që mund të jetë e vazhdueshme.

Gjuha e raporteve në anglisht

Data e dorëzimit në bankë

Jo më vonë se 15 muaj pas përfundimit të projektit

PASQYRA B

PËRKUFIZIMET E EURIBORIT DHE LIBORIT

A. EURIBORI

“EURIBOR” do të thotë:

për sa i përket çdo periudhe përkatëse, përfshirë një periudhë reference me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël ose çdo periudhë tjetër njëmuajore, ose më shumë, norma e interesit për depozitat në euro për një periudhë të përbërë nga numri i muajve të plotë që korrespondojnë më afër me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

për sa i përket një periudhe përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në euro për një afat kohor njëmuajor;

(periudha për të cilën norma përcaktohet, tani e tutje si “Periudha përfaqësuese”),

publikuar në orën 11:00 paradite sipas orës së Brukselit, ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme nga Banka ditën (“Data e ricaktuar”) që përkon me dy ditë pune zyrtare përkatëse para ditës së parë të periudhës në fjalë, në faqen e Reuters-it EURIBOR 01, ose faqen pasuese ose çdo mënyrë tjetër publikimi të zgjedhur nga Banka për këtë qëllim.

Në rast se një normë nuk publikohet në mënyrë të tillë, atëherë Banka iu kërkon zyrove kryesore të eurozonës në katër banka kryesore të eurozonës, të zgjedhura nga Banka, të kuotojnë normën ofruar shumave të ngjashme rreth orës 11:00 paradite, me orën e Brukselit, në datën e ricaktuar, në tregun ndërbankar të eurozonës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma për atë datë të ricaktuar do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse sigurohen më pak se dy kuotime, norma për datën e ricaktuar do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuar nga bankat kryesore në eurozonë, përzgjedhur nga Banka, rreth orës 11:00 paradite me orën e Brukselit në ditën që përkon dy ditë pune zyrtare përkatëse pas datës së ricaktuar, për hua në euro në shuma të ngjashme me Bankat kryesore Europiane për një periudhë të njëjtte me periudhën përfaqësuese.

A. LIBOR USD

“LIBOR” do të thotë, për sa i përket USD:

për sa i përket çdo periudhe përkatëse, përfshirë një periudhë reference me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël ose çdo periudhë tjetër njëmuajore ose më shumë, norma e interesit për depozitat në euro për një periudhë të përbërë nga numri i muajve të plotë që korrespondojnë më afër me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

për sa i përket një periudhe përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në

USD për një afat kohor njëmuor;

(periudha për të cilën norma përcaktohet, tani e tutje si “Periudha përfaqësuese”)

vendosur nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe publikuar nga kanalet e lajmeve financiare në orën 11:00 paradite sipas orës së Londrës ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme nga Banka ditën (“Data e ricaktuar”) që përkon me dy ditë pune zyrtare Londineze para ditës së parë të periudhës në fjalë.

Në rast se kjo normë nuk publikohet në mënyre të tillë nga kanalet e lajmeve financiare të pranueshme për Bankën, atëherë Banka iu kërkon zyrove kryesore të Londrës në katër banka kryesore në tregun ndërbankar të Londrës, të përzgjedhura nga Banka, të kuotojnë normën ofruar depozitave të ngjashme në USD rreth orës 11:00 paradite, me orën e Londrës në datën e ricaktuar, në Bankat kryesore në tregun ndërbankar të Londrës, për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse sigurohen më pak se dy kuotime, Banka do t’i drejtohet zyrove kryesore të New York-ut në katër banka kryesore në tregun ndërbankar të New Yorkut, përzgjedhur nga Banka, për të kuotuar normën e ofruar prej tyre depozitave të ngjashme rreth orës 11:00 paradite me orën e New Yorkut në ditën që përkon me dy ditë pune zyrtare New Yorkeze pas datës së ricaktuar, në bankat kryesore në tregun European për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

A. LIBOR GBP

“LIBOR” do të thotë, për sa i përket GBP-së:

për sa i përket çdo periudhe përkatëse, përfshirë një periudhë reference me shtrirje fikse dhe normë interesi variabël ose çdo periudhë tjetër njëmuore ose më shumë, norma e interesit për depozitat për një periudhë të përbërë nga numri i muajve të plotë që korrespondojnë më afër me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

për sa i përket një periudhe përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në GBP për një afat kohor njëmuor;

(periudha për të cilën norma përcaktohet, tani e tutje si “Periudha përfaqësuese”)

vendosur nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe publikuar nga kanalet e lajmeve financiare në orën 11:00 paradite sipas orës së Londrës ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme nga Banka ditën (“Data e ricaktuar”) në të cilën periudha në fjalë fillon, nëse ajo ditë nuk përkon me ditë pune zyrtare Londineze, ditën pasardhëse përkon me një ditë zyrtare pune Londineze.

Në rast se një normë nuk publikohet në mënyre të tillë nga kanalet e lajmeve financiare të pranueshme për Bankën, atëherë Banka iu kërkon zyrove kryesore të Londrës në katër banka kryesore në tregun ndërbankar të Londrës, të përzgjedhura nga Banka “Bankat e referencës” të kuotojnë normën ofruar depozitave të ngjashme në GBP rreth orës 11:00 paradite, me orën e Londrës në datën e ricaktuar, në bankat kryesore në tregun ndërbankar të Londrës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve.

Nëse sigurohen më pak se dy kuotime, norma do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuar rreth orës 11:00 paradite me orën Londineze në datën e ricaktuar nga bankat kryesore në Londër (përzgjedhur nga Banka) për hua në GBP në shumën të ngjashme me bankat kryesore europiane për një periudhe të njëjtë me periudhën përfaqësuese.

A. Të Përgjithshme

Për qëllime të përkufizimeve të mësipërme

“Ditë pune zyrtare Londineze” do të thotë një ditë në të cilën bankat janë hapur për veprimtari normale në Londër dhe “Ditë pune zyrtare New Yorkeze” do të thotë një ditë në të cilën bankat janë hapur për veprimtari normale në New York.

Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritjet e përcaktuara në këtë pasqyrë do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, me afërsi 100/1000 e një pikë përqindjeje, duke rrumbullakosur gjysmat.

Banka do të informojë Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra prej saj.

Nëse një nga dispozitat e mësipërme nuk pajtohet me dispozitat e pranuar brenda kuadrut të

EURIBOR FBE dhe EURIBOR ACI, për sa i takon EURIBOR ose Shoqatës së Bankierëve, Britanikë për sa i takon LIBOR, atëherë Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund ta përmirësojë dispozitën për ta përputhur me dispozitat e tjera.

PASQYRA C

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM (NENI 1.02 (2))
VENDI-PROJEKTI

Datë:

Ju lutemi vazhdoni me disbursimin e mëposhtëm:

Emërtimi i huasë (*): Rruga Levan-Vlorë

Data e firmosjes (*):

Numri FI i kontratës:

Monedha dhe shuma e kërkuar	
Monedha	Shuma

Data e propozuar e disbursimit:

Interesi

Kriteri bazë i interesit (Neni 3.01)

Norma (% ose shtrirja)

Frekuenca (Neni 3.01)

Vjetore

Gjashtëmujore

Tremujore

Datat e pagesës (Neni 5)

Kapitali

Frekuenca e

shlyerjes

Metodologjia e shlyerjes (Neni 4.01)

Vjetor

Gjashtëmujor

Këste të barabarta

Konstante vjetore

Këste të vetme

Programi i pagimit të kësteve, i specifikuar në kontratë

Data e parë e shlyerjes </>

Data e fundit e shlyerjes </>

Rezervuar për EIB (monedha e kontratë

Shuma totale e kredisë: 23 mio

Disbursuar deri tani:

Bilanci i disbursimeve:

Disbursimi aktual:

Bilanci pas disbursimit:

Afati i disbursimit: </>

Nr. maksimal i disbursimeve: </>

Transhi minimal: </>

Alokimet totale deri tani:

Kushtet precedente: PO/JO

Llogari e Huamarrësit që duhet të kreditohet:

Nr. i llogarisë:

(ju lutem, jepni formatin IBAN në rast disbursimesh në euro ose formatin e përshtatshëm për monedhën përkatëse)

Emri i Bankës dhe adresa:
Ju lutemi transmetoni çdo informacion në lidhje me kërkesën në:
Emri/at dhe firma/at e autorizuar të Huamarrësit:

PASQYRA D

FORMA E VËRTETIMIT NGA HUAMARRËSI

Drejtuar: Bankës Europiane të Investimeve

Nga: </>

Datë:

Të nderuar zotërinj,

Lënda: rruga Levan-Vlorë

Kontrata e financimit ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe Republikës së Shqipërisë të datës 2007 (më poshtë referuar si “Kontrata e financimit”).

Termat e përcaktuar në kontratën e financimit kanë të njëjtin kuptim siç përdoren në këtë dokument.

Për qëllime të nenit 1.04 të kontratës së financimit, në këtë mënyrë ne vërtetojmë si më poshtë:

i) kjo pjesë e fondeve tona dhe (në varësi të disponueshmërisë së financave që duhet të jepen sipas kontratës së financimit), huatë dhe grantet e referuara në pikën e tretë do të na vihen në dispozicion sipas nevojës për të mundësuar ecurinë e pacenuar të ekzekutimit të projektit, në përputhje me përshkrimin teknik;

ii) asnjë miratim për kontrollin e shkëmbimit nuk kërkohet aktualisht me qëllim që të lejohet marrjen e shumës së transhit që duhet të disbursohet më poshtë në llogarinë tonë nr. _____ me _____, shlyerjen e huasë dhe pagesën e të gjitha interesave dhe shumave të tjera të kërkueshme sipas kontratës së financimit;

iii) asnjë situatë nuk ka ndodhur midis atyre të përshkruara në nenin 4.03.A të kontratës së financimit;

iv) dispozitat e parashtruara në nenet 6 dhe 8.04 të kontratës së financimit janë tërësisht të pajtueshme;

v) pas datës së kontratës së financimit, nuk është dhënë asnjë garanci shtesë, preferencial ose prioritet i parashikuar në nenin 7, pa na informuar neve në lidhje me të;

vi) nuk ka asnjë proces gjyqësor aktual, arbitrim, procedim rregullator ose hetim për të cilat na është dërguar ecuria neve ose ndonjë prej enteve të varura nga ne dhe që, nëse janë përcaktuar në mënyrë të kundërt, mund të kishin cenuar materialisht mundësinë tonë për të përmbushur detyrimet tona sipas kontratës së financimit; dhe

vii) që prej ekzekutimit të kontratës së financimit, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje e përmendur në nenin e saj 10.01.

Me respekt

Për dhe në emër të

</>

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.**

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 22.1.2008
Doli nga shtypi më 24.1.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë